

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligji “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Financave
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Tarnspozim i BE
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	- Direktiva nr.2024/1640, datë 31 maj 2024 “Për mekanizmat që duhet të vendosen nga Shtetet Anëtare për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit”, e cila ka ndryshuar Direktivën (BE) 2019/1937, si dhe ka ndryshuar dhe shfuqizuar Direktivën (BE) 2015/849; - Rregullorja nr.2024/1624, datë 31 maj 2024 “Për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit”; - Rregullorja nr.2023/1113, datë 31 maj 2023 “Për informacionin që shoqëron transfertat e fondeve dhe disa aktiveve krypto, si dhe për ndryshimin e direktivës nr. 2015/849”. - Rregullorja nr. 2018/1672 e datë 23 tetor 2018, “Mbi kontrollet e mjeteve monetare që hyjnë ose dalin nga Bashkimi dhe shfuqizimin e Rregullores (KE) nr. 1889/2005”.
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	- Ligji nr.14/2024 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë” - “Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit 2024-2030”. - “Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022 – 2030”, miratuar nga Këshilli i

	Ministrave me VKM nr.88/2023, datë 22.02.2023. - Strategjia sektoriale e menaxhimit të Financave Publike 2023-2030 dhe plani i veprimit 2023-2026. - Projektvendim “Strategjia Kombëtare për parandalimin dhe luftën kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2026-2030 dhe plani i veprimit 2026-2028”. - “Plani i përbashkët i veprimit kundër terrorizmit, BE-Ballkani Perëndimor” (Objektivit 4 të Planit të Përbashkët të Veprimit) - “Plani i veprimit për adresimin e rekomandimeve të Moneyval” Vendimi nr.1 datë 04.09.2018 i Komitetit të Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave (KBLKPP) - Ligji nr.14/2024 “Për miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë”. - Direktiva nr.849/2015 ndryshuar nga 843/2018 të BE “Mbi parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, bërë pjesë e legjislacionit të brendshëm me ligjin nr.9590/2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes të stabilizim asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare”. - Vendim i Këshillit të Ministrave (VKM) nr.454 datë 10.06.2020 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.72/2019 “Për masat shtrënguese Ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”. - VKM nr.668 datë 12.11.2025 “Për formën, mënyrën dhe procedurën e raportimit të të dhënave nga autoritetet licensuese dhe mbikqyrëse”. - VKM nr.458 datë 10.06.2020 “Për përcaktimin e faktorëve dhe të situatave që merren parasysh
--	---

	në vlerësimin e rreziqeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”. - VKM nr.480 datë 01.08.2023 “Për miratimin e rregullave të hollësishëm për procedurën e deklarimit në kufi dhe vendosjes së sanksioneve administrative nga autoritetet doganore”. - VKM nr.13 datë 11.01.2024 “Për përcaktimin e procedurave të konstatimit, të shqyrtimit, të propozimit dhe të vendosjes së masave administrative nga Agjencia e Inteligjencës Financiare”. - VKM nr.51 datë 31.01.2024 “Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë së Inteligjencës Financiare”. - VKM nr.538 datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të detajuara për ngrirjen e përkohshme të fondeve apo të pasurive të tjera të personave ose enteve të shpallura nga strukturat përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara apo organizatat ndërkombëtare ku është palë Republika e Shqipërisë”. - VKM nr.665 datë 12.11.2025 “Për përcaktimin e autoriteteve mbikëqyrëse”.
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	10.04.2026-08.05.2026
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	07/07/2026
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Po 25/06/2026
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2026 – MF – Nr.6
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Drejtuesi i AIF
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (maksimumi 2 faqe)	
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT	
BE ka miratuar paketën e re në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (AML/CFT) ku përfshihen Direktiva (EU) 1640/2024, Rregullorja (EU) 1624/2024 dhe Rregullorja (EU) 1113/2023. Në kuadër të angazhimeve të Shqipërisë në zbatim të MSA, etj., për harmonizimin e kuadrit të saj ligjor me acquis të Bashkimit European në fushën e parandalimit të	

pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si edhe në zbatim të objektivave të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022-2030, dhe “Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit 2024-2030”, etj., është konstatuar se legjislacioni në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, paraqet disa mungesa thelbësore me kërkesat e Direktivës (EU) 2024/1640) dhe dy rregulloret përkatëse të BE-së e cila ndryshoi dhe shfuqizoi Direktivën (EU) 2015/849 të ndryshuar nga Direktiva (EU) 2018/843. Në këtë kuadër, lind si domosdoshmëri përafrimi i plotë i kuadrit ligjor shqiptar me acquis të BE me paketën e re përkatëse të BE-së.

BE-ja vëren se Shqipëria është pjesërisht e përafruar me acquis e BE-së në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe nënvizon se Shqipëria duhet të vazhdojë përafrimin me kuadrin rregullator të BE-së për parandalimin e pastrimit të parave, përfshirë transferimin e fondeve. BE-ja vëren gjithashtu se bilanci i rezultateve të Shqipërisë në fushën e pastrimit të parave është i pabarabartë. BE-ja rikujton se Shqipëria duhet të arrijë përafrim të plotë me acquis-në e BE-së në këtë fushë duke nënvizuar se Shqipëria duhet të demonstrojë rezultat të qëndrueshëm dhe të besueshëm në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit¹.

Paketa e re AML/CFT e BE ka sjellë një sërë risish të cilat duhet të bëhen pjesë e sistemit ligjor shqiptar duke u përqendruar në si më poshtë:

- Direktiva (BE) 2024/1640 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 31 majit 2024 mbi mekanizmat që duhen vendosur nga Shtetet Anëtare për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit, që ndryshon Direktivën (BE) 2019/1937 dhe që ndryshon dhe shfuqizon Direktivën (BE) 2015/849 (ndryshe e njohur si Direktiva e 6-të) paraqet bazën institucionale të kuadrit të ri AML/CFT, duke garantuar që të gjithë Shtetet Anëtare operojnë me standarde të njëjta, mekanizma efektivë dhe bashkëpunim të detyrueshëm në nivel Evropian. Ajo transformon funksionimin e FIU-ve, rrit kapacitetet e mbikëqyrjes, forcon mbrojtjen e subjekteve raportuese dhe harmonizon të gjithë arkitekturën kombëtare me modelin e ri evropian të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

- Rregullorja (BE) 2024/1624 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 31 maj 2024, mbi parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit zgjeron gamën e subjekteve raportuese, forcon vigjilencën e duhur, standardizon identifikimin e pronarëve përfitues dhe rrit transparencën e transaksioneve, përfshirë ato dixhitale. Kjo Rregullore krijon bazën praktike mbi të cilën ndërtohet mbikëqyrja nga AMLA dhe autoritetet kombëtare, duke transformuar mënyrën se si BE-ja e lufton pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

- Rregullorja (BE) 2023/1113 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 31 maj 2023, mbi informacionin që shoqëron transferimet e fondeve dhe disa krypto-aseteve dhe që ndryshon Direktivën (BE) 2015/849, parashikon tashmë rregulla të reja sa i përket sigurimit të gjurmueshmërisë të çdo transaksioni fondesh dhe krypto-asetesh brenda BE-së. Ajo forcon integritetin e sistemit të pagesave duke zbatuar “Travel Rule” në mënyrë të zgjeruar, eliminon portofolët anonimë, harmonizon procedurat e verifikimit dhe rrit transparencën në flukset financiare digjitale dhe tradicionale. Ky instrument është thelbësor për funksionimin praktik të kuadrit të ri evropian AML/CFT dhe për bashkëveprimin me Rregulloren 2024/1624 dhe arkitekturën e re institucionale të BE-së.

Në kuadër të angazhimeve të Shqipërisë në zbatim të MSA, etj., për harmonizimin e kuadrit të saj ligjor me acquis të BE në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si edhe në zbatim të objektivave të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022-2030, dhe “Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit 2024-2030”, etj., është konstatuar se legjislacioni në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, paraqet disa mungesa thelbësore me kërkesat e Direktivës (EU) 2024/1640

¹ Shih Konferenca për Anëtarësimin në Bashkimin Evropian – Shqipëria, Bruksel, 11 prill 2025, AD 4/25, LIMITE, CONF-ALB 4, Pozicioni i Përbashkët i BE-së – Cluster 2: Tregu i Brendshëm, f. 23.

(e cila ndryshoi dhe shfuqizoi Direktivën (EU) 2015/849 të ndryshuar nga Direktiva (EU) 2018/843) dhe rregulloret përkatëse të BE-së.

Këto mangësi krijojnë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve të vendit ndaj standardeve të BE-së, Pozicionit të Përbashkët të Bashkimit Evropian dhe rekomandimeve të FATF-it, si dhe kufizojnë aftësinë e autoriteteve kompetente për të parandaluar dhe hetuar në mënyrë efektive veprimtaritë e pastrimit të parave, veprave penale bazë dhe financimit të terrorizmit dhe për të bashkëpunuar me institucionet Evropiane përkatëse.

Për më tepër, mosharmonizimi i plotë me legjislacionin përkatës të BE-së ndikon negativisht edhe në ecurinë e procesit të integritetit evropian, veçanërisht, në adresimin e Piketës Mbyllëse nr.3 për Kapitullin 4 dhe mbylljen provizore të Kapitullit 4 “Për lëvizjen e lirë të kapitalit”: “Shqipëria është përfruar me *acquis* të BE-së në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (veçanërisht Direktivën kundër Pastrimit të Parave, Rregulloren kundër Pastrimit të Parave dhe Rregulloren e Transferimit të Fondeve, të ndryshuara). Shqipëria demonstroi kapacitet të mjaftueshëm administrativ për të zbatuar dhe zbatuar siç duhet legjislacionin dhe detyrimet përkatëse kundër Pastrimit të Parave / Financimit të Terrorizmit, dhe demonstroi përparim të prekshëm drejt një historiku të fortë suksesi. Shqipëria demonstroi se do të jetë gati të zbatojë plotësisht *acquis* e BE që nga dita e anëtarësimit.

Ndërhyrja ligjore me një ligj të ri do të sigurojë edhe ndjekjen dhe përsosjen në metoda të AIF dhe organet e tjera të inteligjencës financiare, etj., lidhur me zhvillimet më të fundit në tregun financiar dhe atë jofinanciar përkatës, përfshirë por pa u kufizuar në zhvillimet përkatëse të shërbimeve e produkteve financiare digjitale, zhvillimeve teknologjike, etj., dhe kjo mundësohet vetëm me një ligj të ri të integruar.

Për rrjedhojë, vlerësohet se është e nevojshme ndërhyrja normative tërësore për të përditësuar dhe harmonizuar legjislacionin shqiptar për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit me standardet e BE-së, duke adresuar mangësitë e identifikuar dhe duke synuar dhe garantuar një kuadër ligjor efektiv, të unifikuar dhe plotësisht të krahasueshëm me sistemet evropiane.

Në vijim me ndryshimet e mësipërme ligjore, Projektligji duhet të përputhet edhe me rekomandimet e FATF dhe Moneyval në kuadër të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, duhet të marrë në konsideratë ndryshimet e viteve 2024 dhe 2025 që këto rekomandime kanë pësuar. Në këtë kuadër, hartohen ndryshimet ligjore me qëllim përputhshmërinë e plotë me rekomandimet e FATF: Rekomandimi nr.16 “Transferta elektronike” ku tashmë nëpërmjet këtij rekomandimi parashikohen rregulla të cilat qartësojnë informacionin që do të shoqërojë transfertat elektronike; Rekomandimi nr.24 “Transparenca e pronësisë përfituese” ku përcaktohen rregulla të reja që duhet të ndjekin shtetet në përcaktimin dhe identifikimin e pronarëve përfitues; Rekomandimi nr.25 “Transparenca e pronësisë përfituese organizimeve ligjore” ku përcaktohen rregulla të reja mbi identifikimin dhe verifikimin e pronësisë përfituese të organizmave ligjore, përfshirë edhe trustet.

Këto mangësi krijojnë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve të vendit ndaj standardeve të BE-së dhe rekomandimeve të FATF-it, si dhe kufizojnë aftësinë e autoriteteve kompetente për të parandaluar dhe hetuar veprimtaritë e pastrimit të parave, veprave penale bazë dhe financimit të terrorizmit dhe për të bashkëpunuar me institucionet Evropiane përkatëse. Për më tepër, mosharmonizimi i plotë me legjislacionin relevant të BE-së ndikon negativisht edhe në ecurinë e procesit të integritetit evropian, veçanërisht në kuadër të Kapitullit 4 “Për lëvizjen e lirë të kapitalit”.

Për rrjedhojë, vlerësohet se është e nevojshme ndërhyrja normative tërësore për të përditësuar dhe harmonizuar legjislacionin shqiptar për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit me standardet e BE-së, duke adresuar mangësitë e identifikuar dhe duke synuar dhe garantuar një kuadër ligjor efektiv, të unifikuar dhe plotësisht të krahasueshëm me sistemet evropiane.

OBJEKTIVAT

Qëllimi i këtij Projektligji është mbrojtja e sistemit financiar dhe e ekonomisë në tërësi nga kërcënimet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, duke forcuar integritetin e sistemit parandalues në vend dhe duke kontribuar për paqen, sigurinë si dhe përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare të fushës.

Në funksion të këtij qëllimi të përgjithshëm, synohet:

- 1. Përafrimi i plotë me acquis të BE-së** - Harmonizimi i plotë i kuadrit ligjor shqiptar me acquis të BE-së në fushën PP/FT, duke integruar tërësisht dispozitat e AMLD6 dhe akteve përkatëse zbatuese, nëpërmjet ndryshimeve ligjore dhe koordinimit ndërinstitucional.
- 2. Përmbushja e rekomandimeve të FATF/MONEYVAL** - Zbatimi i masave për adresimin e rekomandimeve të FATF/MONEYVAL, duke reflektuar edhe ndryshimet e viteve 2024–2025, me synim përmirësimin e treguesve në ciklin e ardhshëm të vlerësimit.
- 3. Zvogëlimi i rreziqeve të PP/FT përmes politikave dhe bashkëpunimit** - Reduktimi i rreziqeve kombëtare të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit nëpërmjet forcimit të politikave, koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional.
- 4. Parandalimi dhe raportimi i produkteve të krimit dhe fondeve terroriste** - Forcimi i mekanizmave të identifikimit, verifikimit dhe raportimit nga subjektet raportuese për të parandaluar hyrjen dhe qarkullimin e fondeve të paligjshme në sistemin financiar.
- 5. Zbulimi dhe goditja e kërcënimeve të PP/FT** - Rritja e kapaciteteve analitike dhe operacionale për identifikimin dhe goditjen e skemave të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
- 6. Rregullimi i sektorëve të rinj me rrezik të lartë** -Vendosja e një kuadri të qartë rregullator për ofruesit e shërbimeve të mjeteve virtuale dhe transfertat e krypto-aseteve.
- 7. Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar** - Përmirësimi i mekanizmave të shkëmbimit të informacionit ndërmjet autoriteteve kombëtare dhe atyre ndërkombëtare (BE, AMLA, etj.).
- 8. Përmirësimi i sistemit të monitorimit dhe analizës së rrezikut** - Zhvillimi i një qasjeje më të avancuar të bazuar në rrezik, duke përdorur vlerësimin kombëtar dhe analizat sektoriale.
- 9. Rritja e efektivitetit të sanksioneve dhe masave administrative** - Vendosja e një sistemi sanksionesh më të qarta, proporcionale dhe parandaluese për shkeljet e kuadrit PP/FT.

OPSIONET E POLITIKAVE

Opsionet janë:

Opsioni 0 / Status quo: vijimi me ligjin aktual, me Ligjin nr.9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar. Megjithatë, duke qenë se në kuadrin ligjor shqiptar evidentohen boshllëqe në drejtim të përafrimit të plotë me legjislacionin e BE-së, si dhe kufizime në adresimin e risqeve të reja (p.sh. krypto-asetet, transparenca e pronësisë përfituese, mekanizmat e avancuar të bashkëpunimit), ky opsion nuk mund të konsiderohet si i përshtatshëm për përmbushjen e objektivave që rrjedhin nga procesi i integritetit evropian dhe detyrimet ndërkombëtare.

Avantazhet

- **Stabilitet rregullator afatshkurtër:** Ruhet kuadri ekzistues pa krijuar pasiguri ose kosto tranzicioni për subjektet e detyruara dhe institucionet.
- **Kosto minimale financiare dhe administrative:** Nuk kërkohen burime shtesë për hartimin dhe zbatimin e ndryshimeve ligjore apo për adaptimin institucional.
- **Lehtësim për subjektet e detyruara në afat të shkurtër:** Shmanget nevoja për përshtatje me kërkesa të reja ligjore, procedura apo sisteme raportimi.

Disavantazhet

- **Mospërputhje me acquis të BE-së:** Nuk sigurohet harmonizimi me direktivat dhe rregulloret e fundit të BE-së (AMLD6, AMLA), duke penguar progresin në procesin e integritetit evropian.
- **Mosadresim i rekomandimeve të FATF/MONEYVAL:** Rrezikohet përkeqësimi i vlerësimit ndërkombëtar dhe rritja e riskut reputacional për vendin.
- **Mangësi në adresimin e rrezeve të reja:** Kuadri aktual nuk përfshin në mënyrë të plotë zhvillimet e reja si krypto-asetet, strukturat komplekse të pronësisë apo teknikat moderne të pastrimit të parave.
- **Efektivitet i kufizuar i sistemit PP/FT:** Mekanizmat aktualë të analizës, raportimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional mbeten të pjesshëm dhe më pak eficientë krahasuar me standardet e reja.

Opsioni 1 (jorregullator):- nënkupton marrjen e masave jorregullatore si kryerja e fushatave ndërgjegjëse dhe rritja e kontrolleve

Ky opsion konsiston në ndërmarrjen e masave jorregullatore, si organizimi i fushatave ndërgjegjëse për subjektet e detyruara dhe publikun, si dhe rritja e kontrolleve dhe monitorimit nga autoritetet kompetente, pa ndryshuar kuadrin ligjor ekzistues.

Avantazhet

- **Kosto relativisht e ulët:** Nuk kërkon ndryshime ligjore apo reforma të thella institucionale, duke reduktuar barrën financiare dhe administrative.
- **Zbatim i shpejtë:** Masat si trajnime, udhëzime dhe fushata ndërgjegjëse mund të implementohen menjëherë.

Disavantazhet

- **Nuk adreson boshllëqet ligjore:** Mangësitë strukturore të kuadrit aktual (sidomos në raport me acquis të BE-së) mbeten të pandryshuara.

- **Përafrim i pamjaftueshëm me standardet ndërkombëtare:** Nuk siguron harmonizim me paketën e re AML të BE-së dhe rekomandimet e përditësuara të FATF.
- **Ndikim afatshkurtër:** Efektet e fushatave ndërgjegjësuere mund të jenë të përkohshme dhe të mos çojnë në ndryshime të qëndrueshme strukturore.
- **Nuk garanton arritjen e objektivave të reformës:** Ky opsion nuk mundëson përmbushjen e objektivave strategjike, veçanërisht në drejtim të integritetit evropian dhe përmirësimit të vlerësimeve ndërkombëtare.

Opsioni 2 – Ndryshimi i ligjit në fuqi

Ky opsion konsiston në ndryshimin e ligjit ekzistues nr. 9917/2008 nëpërmjet amendimeve të shumta dhe të thelluara, me qëllim përafrimin me acquis të BE-së dhe standardet ndërkombëtare. Megjithatë synon përmirësimin e kuadrit aktual, ai bazohet mbi një strukturë ligjore ekzistuese që nuk është ndërtuar fillimisht në përputhje me arkitekturën e re evropiane.

Avantazhet

- **Përmirësim i ndjeshëm i kuadrit aktual:** Mundëson adresimin e një pjese të konsiderueshme të mangësive ekzistuese pa kaluar në një ligj tërësisht të ri.
- **Kosto më e moderuar se një ligj i ri:** Krahësuar me hartimin e një kuadri të ri nga e para, kërkon më pak burime financiare dhe institucionale.
- **Vazhdimësi juridike dhe institucionale:** Ruhet baza ekzistuese, duke shmangur një “shkëputje” të menjëhershme nga sistemi aktual.

Disavantazhet

- **Strukturë ligjore e fragmentuar dhe e mbivendosur:** Ndryshimet e shumta mbi një ligj të vjetër krijojnë një tekst të komplikuar, me rrezik për paqartësi interpretimi dhe zbatim jo uniform.
- **Përafrim jo i plotë me acquis të BE-së:** Ligji ekzistues nuk përputhet plotësisht me qasjen e re të BE-së (AML package), duke e bërë të vështirë harmonizimin e plotë vetëm përmes amendimeve.
- **Mosadresim i plotë i reformës strukturore:** Ky opsion nuk lejon rindërtimin e sistemit mbi parime të reja (p.sh. qasje e integruar, rol i AMLA, mekanizma të rinj të bashkëpunimit).
- **Kompleksitet në zbatim:** Subjektet dhe autoritetet përballen me një kuadër të ndryshuar pjesërisht, shpesh më të vështirë për t’u interpretuar sesa një ligj i ri i strukturuar qartësisht.
- **Efektivitet më i kufizuar në afatgjatë:** Ndryshimet inkrementale nuk garantojnë një sistem modern dhe plotësisht funksional sipas standardeve të reja ndërkombëtare.

Opsioni 3 – Hartimi dhe miratimi i një ligji të ri

Ky opsion konsiston në hartimin dhe miratimin e një ligji të ri tërësor për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, i ndërtuar nga baza mbi parimet dhe kërkesat e acquis të BE-së (AMLD6, AML package) dhe standardet e FATF. Ky kuadër i ri synon të krijojë një strukturë moderne, të integruar dhe koherente, duke adresuar në mënyrë të plotë mangësitë e identifikuara në legjislacionin ekzistues dhe duke reflektuar zhvillimet më të fundit në këtë fushë.

Avantazhet

- **Përafrim i plotë dhe i qëndrueshëm me acquis të BE-së:** Siguron harmonizim të plotë me kuadrin e ri evropian dhe përmbush kërkesat e procesit të integritetit.
- **Qasje e re dhe e integruar ligjore:** Ndërtim i një sistemi të ri, të strukturuar dhe koherent, duke shmangur fragmentimin dhe mbivendosjet.
- **Adresim i plotë i mangësive ekzistuese:** Zgjidh në mënyrë gjithëpërfshirëse boshllëqet ligjore dhe institucionale të identifikuar.
- **Përfshirje e rrezeve dhe zhvillimeve të reja:** Rregullon në mënyrë të plotë krypto-asetet, transfertat digjitale, transparencën e pronësisë përfituese dhe mekanizmat modernë të kontrollit.
- **Rritje e efektivitetit të sistemit PP/FT:** Forcon rolin e institucioneve, analizën financiare, raportimin dhe bashkëpunimin ndërinstitucional dhe ndërkombëtar.
- **Përmirësim i rezultateve në FATF/MONEYVAL:** Ndikon pozitivisht në vlerësimet ndërkombëtare
- **Rritje e besimit dhe integritetit të sistemit financiar:** Përmirëson transparencën, sigurinë dhe klimën e investimeve.

Disavantazhet

- **Kosto fillestare më e lartë:** Kërkon burime të konsiderueshme për hartim, konsultim, miratim dhe zbatim (administrativ dhe financiar).
- **Nevojë për përshtatje të gjerë nga subjektet e detyruara:** Subjektet duhet të përshtasin procedurat, sistemet dhe kapacitetet e tyre me kërkesat e reja.
- **Ngarkesë për institucionet publike:** Kërkohet rritje e kapaciteteve njerëzore, teknike dhe organizative

Pavarësisht kostove dhe sfidave afatshkurtra, ky opsion garanton një **reformë të plotë, koherente dhe të qëndrueshme** të sistemit të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Për këtë arsye, ai konsiderohet **opsioni i preferuar**, pasi siguron përmbushjen e objektivave strategjike, harmonizimin me acquis të BE-së dhe rritjen e efektivitetit të kuadrit ligjor në afatgjatë.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përshkruajë ndikimet në mënyrë sasore (monetare) dhe cilësore (narrative) mbi buxhetin dhe grupet e tjera të prekura.

Ndikimi social

Përafrimi i legjislacionit shqiptar në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit me Direktivën (BE) 2024/1640, Rregulloren (BE) 2024/1624 dhe Rregulloren (BE) 2023/1113 pritet të ketë një ndikim të ndjeshëm dhe pozitiv në jetën shoqërore dhe ekonomike të vendit. Ky proces përafrimi synon forcimin e kuadrit ligjor dhe institucional për mbrojtjen e interesit publik, si dhe rritjen e efektivitetit të mekanizmave shtetërorë për parandalimin dhe goditjen e veprimtarive kriminale financiare.

Zbatimi i standardeve të harmonizuara evropiane do të kontribuojë në rritjen e transparencës dhe integritetit në veprimtarinë ekonomike, duke kufizuar mundësitë për abuzim me sistemin financiar, si dhe për fshehjen e pasurive me origjinë të paligjshme.

Qytetarët dhe bizneset që respektojnë standardet ligjore do të përfitojnë nga një mjedis më i drejtë dhe më konkurrues, duke ndikuar kështu drejtpërdrejtë në funksionimin e shtetit të së drejtës.

Përmirësimi i mekanizmave për identifikimin e dërguesve të transfertave, transparencja në lidhje me pronarët përfitues dhe gjurmimi i transfertave financiare, përfshirë ato që lidhen me asetet krypto, do të ndikojë në formalizimin e mëtejshëm të marrëdhënieve ekonomike dhe do të rrisë sigurinë financiare për qytetarët.

Ligji i ri pritet të ketë ndikim pozitiv në luftën kundër korrupsionit, krimit të organizuar dhe formalizimin e tregut.

Përafrimi i legjislacionit vendas me 3 (tre) aktet ligjore evropiane do të përbëjë një hap të rëndësishëm drejt forcimit të shtetit të së drejtës dhe rritjen e besimit qytetar përballë institucioneve publike. Gjithashtu, ky ligj do të përmirësojë / reflektojë angazhimin e Shqipërisë në zbatimin e standardeve ndërkombëtare në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe armëve të dëmtimit në masë.

Reforma pritet të ketë një ndikim të përgjithshëm pozitiv shoqëror përmes forcimit të sundimit të ligjit, reduktimit të infiltrimit kriminal në ekonomi, përmirësimit të besimit në institucione dhe krijimit të kushteve më të drejta të tregut. Efektet e mundshme negative afatshkurtra lidhen kryesisht me rritjen e detyrimeve të pajtueshmërisë dhe barrën administrative për subjektet raportuese dhe klientët, të cilat duhet të zbuten përmes zbatimit proporcional, udhëzimeve specifike për sektorin dhe mbikëqyrjes së bazuar në risk.

Përafrimi i legjislacionit shqiptar me legjislacionin e BE-së në fushën e pastrimit të parave dhe parandalimit të financimit të terrorizmit dhe armëve të dëmtimit në masë pritet, që në mënyrë indirekte të ketë efekte pozitive në aspektin mjedisor.

Miratimi i një kuadri të ri ligjor të përafruar me direktivën përkatëse dhe dy rregulloret e BE në këtë fushë do të nxisë përdorimin e teknologjisë, proceseve digjitale, shkëmbimin elektronik të të dhënave dhe automatizimin e sistemeve raportuese, duke reduktuar prodhimin e dokumentacionit fizik.

Ndikimi mjedisor i reformës pritet të jetë i kufizuar dhe kryesisht indirekt. Një efekt modest pozitiv pritet përmes dixhitalizimit të raportimit, shkëmbimit të të dhënave dhe aksesit në regjistra, duke zvogëluar proceset në letër dhe disa lëvizje administrative. Çdo rritje në përdorimin e infrastrukturës së TIK-ut nuk pritet të jetë aq e rëndësishme sa të krijojë një ndikim negativ material në mjedis.

Harmonizimi i procedurave për kujdesin e duhur ndaj klientit, raportimin e transaksioneve dhe gjurmimi i transfertave financiare, përfshirë ato të aseteve krypto, do të kontribuojë në uljen e përdorimit të letrës, në optimizimin e proceseve administrative dhe në reduktimin e ndikimit mjedisor nga veprimtaria e institucioneve financiare. Kjo qasje është në përputhje me parimet e tranzicionit digjital dhe të ekonomisë së qëndrueshme të promovuara nga BE. Në tërësi, ky përafrim kontribuon në krijimin e një administrate dhe tregu financiar më efikas dhe më të përgjegjshëm ndaj mjedisit, në përputhje me politikat mjedisore dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të Bashkimit Evropian.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare. (jo më shumë se 7 rreshta)

Opsioni i preferuar është Opsioni nr.3: Hartimi dhe miratimi i një ligji të ri të vetëm të posaçëm të harmonizuar me *acquis* të BE-së, sepse:

- është **i vetmi** që garanton përputhje të plotë me acquis të BE-së, pra, siguron përmbushjen e kërkesave të Direktivës (Direktiva nr.2024/1640, datë 31 maj 2024 “Për mekanizmat që duhet të vendosen nga Shtetet Anëtare për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit”, e cila ka ndryshuar Direktivën (BE) 2019/1937, si dhe ka ndryshuar dhe shfuqizuar Direktivën (BE) 2015/849), dhe të dy Rregulloreve përkatëse (Rregullorja nr.2024/1624, datë 31 maj 2024 “Për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit” dhe Rregullorja nr.2023/1113, datë 31 maj 2023 “Për informacionin që shoqëron transfertat e fondeve dhe disa aktiveve krypto, si dhe për ndryshimin e Direktivës nr. 2015/849”) dhe akteve të tjera të zbatueshme të BE-së;
- adreson ndryshimet e thella dhe substanciale të nevojshme, të cilat **nuk mund të realizohen me amendime të pjesshme**;
- krijon një kuadër të unifikuar dhe koherent, duke adresuar mangësitë ekzistuese në vlerësimin e riskut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe qasjen e autoriteteve kompetente në të dhëna financiare, krijon mundësi efektive për akses në informacionin e regjistrave publikë dhe informacionin dhe dokumentacionin e mbajtur nga organet kompetente shqiptare dhe bashkëpunimin dhe koordinimin e punës me autoritetet përkatëse të BE-së, etj., për ndërhyrje efektive në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- minimizon rrezikun e fragmentimit të rregullimit, rrit efektivitetin e sistemit të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe përmirëson përputhshmërinë me kërkesat e Kapitullit 4;
- ndryshimet që propozohen në ligjin në fuqi janë thelbësore dhe në një masë të konsiderueshme për nga teknika legjislative, pra, prekin ndryshim në mbi 50% të aktit;
- ky opsion shkon përtej thjesht ndryshimit të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe kërkon rishikimin gjithëpërfshirës të gjithë legjislacionit përkatës, përfshirë por pa u kufizuar në Ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, Ligjin për Bankat, Ligjin për Lojërat e Fatit, Ligjin për Regjistrin e Pronarëve Përfitues dhe aktet e tjera të lidhura të cilat nuk janë ende të përafruara plotësisht me tre aktet e acquis të BE-së të përfshira në këtë paketë rregullatore;
- modernizon të gjithë sistemin parandalues dhe e përshtat atë me rreziqet e reja financiare dhe teknologjike;
- hartimi dhe miratimi i një ligji të ri të vetëm do të sigurojë edhe ndjekjen dhe përsosjen në metoda të AIF dhe organet e tjera të inteligjencës financiare, etj., lidhur me zhvillimet më të fundit në tregun financiar dhe atë jofinanciar përkatës, përfshirë por pa u kufizuar në zhvillimet përkatëse të shërbimeve e produkteve financiare digjitale, zhvillimeve teknologjike, etj., dhe kjo mundësohet vetëm me një ligj të ri të integruar;
- ndërhyrja rregullatore është e domosdoshme, pasi zgjidhja e problemit kërkon miratimin e ligjeve dhe rregulloreve të reja që sigurojnë harmonizimin e plotë me standardet evropiane, në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga neni 70 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Kjo qasje përfaqëson jo vetëm një detyrim ligjor, por edhe një angazhim politik të Shqipërisë në procesin e negociatave për anëtarësim, duke kontribuar në mbylljen provizore të Kapitullit 4 dhe në avancimin e procesit të integritimit evropian;
- përmirëson vlerësimet ndërkombëtare dhe reputacionin e vendit;
- justifikon kostot fillestare me përfitime të dukshme afatgjata.

Kostoja e përlogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti 1	Viti 2	Viti 3
17,100,000 lekë	6,650,000 lekë	712,500 lekë

Kostoja e buxhetit të shtetit e përlogaritur sipas Opsionit 1 përfshin një vlerë të përafërt të kostove të sistemeve IT që planifikohen të kryhen duke integruar modulet e reja në sistem e AIF. Investimi parashikohet të kryhet në dy vitet e para (në total në vlerën rreth 250,000 EUR) dhe më pas, pas vitit të tretë e më tej kostoja do të konsistojë vetëm në koston e mirëmbajtjes së sistemeve.

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar)?

Procesi i konsultimit publik për Projektligjin zhvillohet në përputhje të plotë me kërkesat e legjislacionit në fuqi për njoftimin dhe konsultimin me publikun, duke garantuar transparencë, gjithëpërfshirje dhe pjesëmarrje aktive të të gjitha palëve të interesuara. Ky proces synon mbledhjen e komenteve dhe sugjerimeve të informuara, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe zbatueshmërisë së projektaktit. Konsultimi realizohet përmes publikimit të Projektligjit në faqen zyrtare të institucionit dhe në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik, ku publiku dhe grupet e interesit do të kenë mundësi të paraqesin komente dhe sugjerime brenda afatit ligjor të parashikuar.

Projektligji është publikuar në RENJK në datë 10.04.2026 deri më 08.05.2026. Palët e interesit u angazhuan nëpërmjet publikimit të projektligjit dhe të dokumenteve shoqëruese në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik (RENJKP) dhe në faqen zyrtare të AIF, komunikimeve zyrtare me shkresa dhe me postë elektronike me institucionet dhe organizatat e interesuara, si dhe takimeve teknike e ndërinstitutionale me grupet e punës gjatë periudhës së konsultimit. Komentet u paraqitën me shkrim nga palët e mëposhtme:

- Dhoma Amerikane e Tregtisë
- Partners Albania
- Shoqata Shqiptare e Bankave(AAB)

Në pëfundim u vlerësua çdo koment në funksion të përmirësimit të projektligjit.

Përveç konsultimit elektronik, janë parashikuar takime të drejtpërdrejta dhe/ose virtuale me grupet kryesore të interesit, përfshirë subjektet raportuese, organet mbikëqyrëse, institucionet ligjzbatuese, përfaqësues të sektorit financiar dhe jo-financiar, si dhe organizatat e shoqërisë civile.

Grupet e interesit në procesin e konsultimit përfshijnë profesionistët e detyruar (noterët, avokatët, kontabilistët dhe audituesit, ndërmjetësit e pasurive të paluajtshme), zyrtarët publikë me përgjegjësi në parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (PP/FT), agjencitë ligjzbatuese, organet e drejtësisë, si dhe organizatat ndërkombëtare partnere.

Gjithashtu, janë zhvilluar takime fizike me përfaqësues të organeve rregullatore mbikëqyrëse të subjekteve raportuese në kuadër të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe armëve të dëmtimit në masë, si:

Shoqatës së Bankave, AMF, Dhomës Kombëtare të Avokatisë, Dhomës Kombëtare të Noterëve, Instituti i Ekspertëve Kontabël (IEKA), Bordi i Mbikqyrjes Publike, Drejtoria e Përgjithshme e

Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Komiteti i Bashkërendimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, etj.

Projektligji është hartuar me kontribut kryesor të Agjencisë së Inteligjencës Financiare (AIF) dhe me ekspertizën e dhënë nga GIZ, projekti SANECA.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?(jo më shumë se 5 rreshta)

Zbatimi dhe monitorimi i Projektligjit do të organizohen në mënyrë të strukturuar dhe të koordinuar ndërinstitucionale, me qëllim sigurimin e zbatimit efektiv dhe të unifikuar të dispozitave të tij. Institucioni kryesor përgjegjës për monitorimin e përputhshmërisë është Agjencia e Inteligjencës Financiare (AIF), ndërsa autoritetet mbikëqyrëse sektoriale, përfshirë Bankën e Shqipërisë, Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, Drejtorinë e Tatimeve, Drejtorinë e Doganave dhe organet e tjera (Ministria e Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Noterëve, Dhoma Kombëtare e Avokatisë, Instituti i Ekspertëve Kontabël, etj.) do të jenë përgjegjëse për mbikëqyrjen e subjekteve në fushën e tyre të kompetencës.

Mekanizmat kryesorë të zbatimit

- Nxjerrja e akteve nënligjore dhe udhëzimeve për zbatim, për të siguruar interpretim dhe zbatim të qartë nga subjektet raportuese dhe organet mbikëqyrëse.
- Hartimi i planeve të trajnimit për subjektet raportuese, autoritetet mbikëqyrëse dhe institucionet ligjzbatuese për t'i pajisur me njohuritë e reja procedurale dhe teknike.
- Përditësimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit ('TI') në AIF, mbikëqyrësit sektoriale dhe subjektet raportuese për të lehtësuar raportimin elektronik, shkëmbimin e të dhënave dhe analizën e riskut.
- Rritja e kapaciteteve njerëzore, përfshirë rekrutime ose rispecializim të stafit për të mbështetur zbatimin praktik të ndryshimeve ligjore.

Mekanizmat kryesorë të monitorimit

- Inspektive dhe kontrole periodike nga Agjencia e Inteligjencës Financiare (AIF) për të vlerësuar përputhshmërinë e subjekteve me kërkesat e ligjit dhe aktet nënligjore.
- Mbikëqyrje e bazuar në risk, e realizuar nga autoritetet sektoriale sipas profileve të riskut të subjekteve dhe veprimtarive ekonomike.
- Raportime të detyrueshme periodike nga subjektet raportuese për transaksionet e dyshimta, veprimtaritë e mbikëqyrura dhe masat e marra për menaxhimin e riskut të PP/FT.
- Analizë vjetore e efektivitetit nga AIF, përfshirë matjen e indikatorëve kyç të performancës (KPI) si numri i raportimeve, cilësia e tyre, masat e marra dhe rezultatet në referimet penale.
- Koordinim ndërinstitucional përmes komiteteve dhe forumeve teknike për monitorim të përbashkët të zbatimit dhe adresimin e sfidave.

Përgjegjësitë institucionale

- **Agjencia e Inteligjencës Financiare (AIF):** Monitorim i përgjithshëm, inspektive, analiza të riskut, hartim udhëzimesh, koordinim, raportim vjetor dhe rekomandime për përmirësime.
- **Autoritetet mbikëqyrëse sektoriale:** Mbikëqyrje e subjekteve në përputhje me standardet sektoriale; kryerja e kontroleve, vendosja e masave administrative dhe raportimi i gjetjeve të AIF.
- **Subjektet raportuese:** Zbatim i detyrimeve ligjore, përditësim i politikave të brendshme, trajnim i stafit, raportim i rasteve të dyshimta dhe bashkëpunim me inspektimet e autoriteteve.
- **Institucionet ligjzbatuese:** Trajtimi i referimeve të bëra nga AIF, kryerja e hetimeve dhe koordinimi në rastet e PP/FT.
- **Ministria përgjegjëse:** Ndjekja e progresit të zbatimit dhe rishikimi i kuadrit ligjor nëse lind nevoja.

Masat kryesore për zbatim efektiv

- Përgatitja dhe publikimi i paketës së akteve nënligjore brenda afateve të përcaktuara.
- Krijimi i një mekanizmi monitorimi të vazhdueshëm të performancës së institucioneve zbatuese.
- Përcaktimi i indikatorëve matës për vlerësimin e efektivitetit.
- Rishikimi periodik i kuadrit rregullator në bazë të rezultateve të monitorimit dhe praktikave ndërkombëtare.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

Jepni kontekstin e politikës.

BE ka miratuar paketën e re në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (AML/CFT) dhe armëve të dëmtimit në masë ku përfshihen Direktiva (EU) 1640/2024, Rregullorja (EU) 1624/2024 dhe Rregullorja (EU) 1113/2023. Në këtë kuadër, lind si domosdoshmëri përafrimi i plotë i kuadrit ligjor Shqiptar me acquis të BE me paketën e re të BE-së.

Paketa e re AML/CFT e BE² ka sjellë një sërë risish të cilat duhet të bëhen pjesë e sistemit ligjor shqiptar duke u përqendruar në si më poshtë:

- **Direktiva (BE) 2024/1640 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 31 majit 2024 mbi mekanizmat që duhen vendosur nga Shtetet Anëtare për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit, që ndryshon Direktivën (BE) 2019/1937 dhe që ndryshon dhe shfuqizon Direktivën (BE) 2015/849 (ndryshe e njohur si direktiva e 6-të)**, paraqet bazën institucionale të kuadrit të ri AML/CFT, duke garantuar që të gjithë Shtetet Anëtare operojnë me standarde të njëjta, mekanizma efektivë dhe bashkëpunim të detyrueshëm në nivel Evropian. Ajo transformon funksionimin e FIU-ve, rrit kapacitetet e mbikëqyrjes, forcon mbrojtjen e subjekteve raportuese dhe harmonizon të gjithë arkitekturën kombëtare me modelin e ri evropian të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

- **Rregullorja (BE) 2024/1624 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 31 maj 2024, mbi parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit** zgjeron gamën e subjekteve raportuese, forcon vigjilencën e duhur, standardizon identifikimin e pronarëve përfitues dhe rrit transparencën e transaksioneve, përfshirë ato dixhitale. Kjo Rregullore krijon bazën praktike mbi të cilën ndërtohet mbikëqyrja nga AMLA dhe autoritetet kombëtare, duke transformuar mënyrën se si BE-ja e lufton pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

- **Rregullorja (BE) 2023/1113 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 31 maj 2023, mbi informacionin që shoqëron transferimet e fondeve dhe disa krypto-aseteve dhe që ndryshon Direktivën (BE) 2015/849**, parashikon tashmë rregulla të reja sa i përket sigurimit të gjurmueshmërisë të çdo transaksioni fondesh dhe krypto-asetesh brenda BE-së. Ajo forcon integritetin e sistemit të pagesave duke zbatuar “Travel Rule” në mënyrë të zgjeruar, eliminon portofolët anonimë, harmonizon procedurat e verifikimit dhe rrit transparencën në flukset financiare digjitale dhe tradicionale. Ky instrument është thelbësor për funksionimin praktik të kuadrit të ri evropian AML/CFT dhe për bashkëveprimin me Rregulloren 2024/1624 dhe arkitekturën e re institucionale të BE-së.

² <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex:52021SC0191>

Bazuar në vlerësimet e Bashkimit Evropian (*Conference on Accession to the European Union – Albania, Brussels, 11 April 2025, AD 4/25, LIMITE, CONF-ALB 4, EU Common Position – Cluster 2: Internal Market, pp. 9–10*), Shqipëria është aktualisht pjesërisht e përafruar me *acquis*-në e BE-së në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Shqipëria duhet të arrijë përafrim të plotë me *acquis*-në për parandalimin e pastrimit të parave, përfshirë transferimin e fondeve, dhe të demonstrojë një bilanc të qëndrueshëm dhe të besueshëm në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

BE-ja nënvizon se Shqipëria duhet të demonstrojë një bilanc të qëndrueshëm dhe të besueshëm në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Task Forca Financiare (FATF) e MONEYVAL, organ ndër-qeveritar i pavarur i Këshillit të Evropës, i cili zhvillon dhe promovon politika për të mbrojtur sistemin financiar global kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve dhe shkatërrimit në masë, duke vlerësuar zbatimin e standardeve në Shqipëri, e përfshiu Shqipërinë në listën gri të pastrimit të parave. Duke marrë parasysh mangësitë strategjike, si dhe vakumin ligjor për parandalimin e pastrimit të parave në Shqipëri, MONEYVAL vlerësoi se një aktivitet i tillë përbën rrezik të lartë dhe duhet të jenë nën monitorim të shtuar. Sipas raportit, Shqipëria paraqet vullnet për ta adresuar problemin, duke punuar me FATF dhe MONEYVAL për të përmirësuar dhe forcuar strategjitë, si dhe efektivitetin në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Sipas Rekomandimeve të FATF për “Standardet Ndërkombëtare për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit”, shtetet duhet të sigurojnë që autoritetet kompetente përkatëse të kenë mekanizma efektivë që mundësojnë bashkëpunimin e tyre dhe të koordinojë e shkëmbejë informacione brenda vendit, atëherë kur është e nevojshme, në lidhje me zbatimin e politikave dhe aktiviteteteve për të luftuar pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe armëve të shkatërrimit në masë.

Gjithashtu, në veçanti, në raportin e vlerësimit të Shqipërisë nga FATF, në analizën e përputhshmërisë me Rekomandimin 24, u vlerësua se ekziston mungesë e mekanizmave në vend që të identifikojnë dhe përshkruajnë proceset për marrjen dhe regjistrimin e informacionit për pronarët përfitues, si dhe mungesa e detyrimit të organeve ligjore për të mbajtur informacion bazë dhe një regjistër përkatës.

Në Forumin Ministror BE-Ballkan Perëndimor për Drejtësinë dhe Çështjet e Brendshme në Tiranë, në datë 5 Tetor 2018, përfaqësuesit e BE-së dhe të Partnerëve të Ballkanit Perëndimor nënshkruan *Planin e Përbashkët të Veprimit për Anti-Terrorizmin për Ballkanin Perëndimor*³. Sipas objektivit 4 të Planit të Përbashkët të Veprimit⁴, Shqipëria ka marrë përsipër harmonizimin e plotë me *acquis* të BE kundër pastrimit të parave.

Hapja e negociatave për Kapitullin 4 dhe të tjerë, paraqet para Shqipërisë kërkesën për angazhim efektiv dhe të shpejtë në përafrimin e plotë të legjislacionit shqiptar me atë të BE në fushën e parandalimit dhe luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe armëve të dëmtimit në masë.

“Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit 2024-2030” dhe Plan i Veprimit parashikon objektiva strategjike dhe masa operationale konkrete për autoritetet shqiptare në parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit dhe, mbi të gjitha, përafrimin e plotë të legjislacionit shqiptar me atë të BE.

Në tetor 2017, nisi procesi i vlerësimit nga Moneyval, i cili u finalizua me miratimin e Raportit të ndërsjelltë të vlerësimit (MER) në korrik 2018. Vlerësimi i Moneyval përqendrohej në raportimet e shteteve në lidhje me përputhshmërinë teknike të kuadrit ligjor të vendit me 40 Rekomandimet e FATF dhe efektivitetin e masave të marra në kuadër të sistemit parandalues të PP/FT. Vlerësimi bazohej mbi të dhënat për periudhën 2011-2017.

³ “Arrangement for the implementation of the Joint Action Plan on Counter-Terrorism for the Western Balkans between the European Commission and the authorities of Albania”/ Envisaged implementing priority actions for the Albanian Authorities.

Si rezultat i vlerësimit u konkludua se, nga 40 Rekomandime të FATF, Shqipëria kishte:

- 1 Rekomandim të papërputhur (NC);
- 10 Rekomandime të përputhur pjesërisht (PC);
- 27 Rekomandime të përputhur gjerësisht (LC);
- 2 Rekomandime të përputhur (C).

Përsa i përket vlerësimit të efektivitetit, nga 11 Rezultate Imediate (IO):

- 2 IO ishin me efektivitet të ulët (LE);
- 7 IO ishin me efektivitet të moderuar (ME);
- 2 IO ishin me efektivitet të substancial (SE).

(Tabelë me rezultatet fillestare të vlerësimit)

Në vijim të këtij vlerësimi, vendi u vendos në monitorim të përforcuar nga Moneyval, si dhe në vitin 2020 u vendos nga FATF në listën e vendeve në monitorim “lista gri”.

Në këtë kuadër, Shqipëria ndërmori menjëherë një angazhim të nivelit të lartë politik për të bashkëpunuar me FATF dhe MONEYVAL për forcuar efektivitetin e sistemit parandalues të PP/FT nëpërmjet dakordësimit të një plani veprimi të përbërë nga 19 pika veprimi, me afat zbatimi brenda një periudhe 3 vjeçare.

Për ndjekjen dhe zbatimin e planit të veprimit, u ngrit grupi ndërinstitucional i punës me Vendimin e Komitetit të Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave, nr.1 datë 19.02.2020 “*Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për ndjekjen dhe përmbushjen e rekomandimeve të grupit të posaçëm të veprimit financiar*”. Ky grup pune drejtohej nga Zëvendëskryeministri, me përbërjen e të gjitha institucioneve përgjegjëse për zbatimin e planit të veprimit dhe AIF kishte rolin e sekretarit teknik për asistimin e grupit të punës. Në tërësinë e tij Plani i Veprimit i dakordësuar prej Shkurt 2020 nuk pati ndryshime në përmbajtjen e tij, përveç zgjatjes së afatit të përbushjes së Planit të Veprimit me 6 (gjashtë) muaj, që u ndikua edhe nga vështirësitë që solli pandemia globale COVID-19. Raportimi mbi zbatimin e Planit të Veprimit realizohej mbi baza 4 mujore. Për gjithë procesin Shqipëria dërgoi 10 (dhjetë) raporte progresi pranë ICRG/FATF, ku më i fundit ishte ai i dërguar në datë 21 Korrik 2023. Ky raportim i fundit ishte një përmbledhje e punës 3 vjeçare të bërë nga të gjitha institucionet përgjegjëse në lidhje me zbatimin e planit të veprimit.

Në plenaren e Korrikut 2023, FATF miratoi përmbushjen e planit të veprimit nga Shqipëria duke evidentuar ndërmarrjen e një sërë nismash ligjore dhe reformash të cilat ndikuan ndjeshëm në rritjen e efektivitetit të sistemit parandalues të PP/FT. Këto masa çuan në daljen nga “lista gri” e FATF.

Tashmë, përputhshmëria teknike, pra, e kuadrit ligjor lidhur me 40 rekomandimet e FATF, sipas vlerësimit të Moneyval, paraqitet si më poshtë:

- 6 Rekomandime të përputhura (C);
- 31 Rekomandime “gjerësisht të përputhura” (LC);
- 2 rekomandime “pjesërisht të përputhura” (PC);
- 1 rekomandim “i pazbatueshëm” (N/A);
- Asnjë rekomandim “i papërputhur” (NC).

Lidhur me dy rekomandimet që janë ende “pjesërisht të përputhura” (PC):

- Rekomandimi 7 “Masat shtrënguese ndërkombëtare për financimin e armëve të shkatërrimit në masë”: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë kanë hartuar dhe bashkë propozuar projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 72/2019 “Për masat shtrënguese

ndërkombëtare në RSH”, miratuar në seancën plenare të datës 14 Dhjetor 2023. Vlerësohet se vendi i ka përmbushur kriteret për rritje të këtij rekomandimi, mirëpo zbatimi nuk është i mundur për shkak se në vitin 2026 pritet të fillojë raundi i ri i vlerësimit të Shqipërisë nga Moneyval.

- Rekomandimi 15 “Teknologjitë e reja - ofruesit e mjeteve virtuale”: Në lidhje me këtë rekomandim synohet një përmbushje sa më e shpejtë dhe ka filluar puna në koordinim të plotë me institucionet përgjegjëse, si dhe me mbështetjen përmes ekspertizës të ofruar në kuadër të “Projektit kundër krimit ekonomik në Shqipëri” (AEC-AL), program i përbashkët i Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian. Vlerësohet se për Rekomandimin 15 mbeten ende të nevojshme zhvillime, për të arritur përmbushjen e rekomandimit.

Për sa i përket efektivitetit është vlerësuar se Shqipëria ka bërë progres në adresimin dhe përmirësimin e efektivitetit në dy IO që rezultuan me efektivitet të ulët.

Lidhur me rekomandimet e sipërpërmendura, deri në periudhën 23 Dhjetor 2025, **Shqipëria ka përfunduar periudhën e përgatitjes dhe është duke u vlerësuar në kuadër të raundit të 6-të të MONEYVAL**, por deri tani **nuk është publikuar ende një raport i ri të vlerësimit të plotë⁵ (mutual evaluation report) nga MONEYVAL për Shqipërinë për raundin e 6-të⁶.**

Në lidhje me **Rekomandimin 7**: Masat shtrënguese ndërkombëtare për financimin e armëve të shkatërrimit në masë, vlerësohet se Shqipëria ndodhet aktualisht në fazën e përputhshmërisë substanciale në praktikë, megjithëse pa një rritje formale të vlerësimit teknik. Autoritetet shqiptare kanë hartuar dhe miratuar ndryshimet përkatëse ligjore në ligjin nr.72/2019, duke adresuar mangësitë që kishin penguar më parë rritjen e nivelit të përputhshmërisë. Në këto kushte, rekomandimi konsiderohet praktikisht i përmbushur nga pikëpamja teknike, ndërkohë që vlerësimi zyrtar mbetet ai i përcaktuar në raportin e fundit të miratuar, deri në përfundimin e raundit të ardhshëm të vlerësimit. Në terminologjinë e MONEYVAL, kjo situatë përfaqëson një përmbushje faktike, pa një “upgrade” formal të vlerësimit teknik në këtë fazë.

Sa i përket **Rekomandimit 15**: Teknologjitë e reja dhe ofruesit e mjeteve virtuale, faza aktuale e përputhshmërisë vlerësohet si përputhshmëri e pjesshme, duke qenë se procesi i përmbushjes është ende në zhvillim. Puna për adresimin e këtij rekomandimi ka filluar, ekziston koordinim institucional ndërmjet autoriteteve përgjegjëse dhe është siguruar mbështetje e konsiderueshme ndërkombëtare, përfshirë asistencën teknike të ofruar në kuadër të projektit AEC-AL, program i përbashkët i Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian. Megjithatë, mbeten ende zhvillime të nevojshme për arritjen e përmbushjes së plotë të rekomandimit, si në aspektin teknik, ashtu edhe në atë operacional. Kjo situatë përkthehet në përputhshmëri të pjesshme, me nevojë për masa shtesë ligjore dhe/ose rregullatore.

Në Qershor 2023, Shqipëria siguroi ftesën për realizimin e vizitës në vend (on-site), procedurë që kryesisht i paraprin daljes së vendeve nga “lista gri”. Në datat 28 – 29 Gusht 2023, u zhvillua vizita në vend (on site) e grupit të ekspertëve vlerësues të planit të veprimit me ICRG/FATF.

Më 27 tetor 2023 u vendos dalja e Shqipërisë nga “lista gri” e pastrimit të parave ku u vlerësuan reformat e ndërmarra nga Shqipëria në adresim të mangësive të identifikuara.

⁵ Shih MONEYVAL (Këshilli i Evropës), *MONEYVAL launches the evaluation process of Albania*, njoftim zyrtar për nisjen e procesit të vlerësimit të Shqipërisë në kuadër të raundit të 6-të të vlerësimit, Strasburg, 14 mars 2025, publikuar në portalin zyrtar të Këshillit të Evropës.

⁶ Shih Agjencia e Inteligjencës Financiare (FIA), *Takime dhe aktivitete përgatitore në kuadër të vlerësimit të ardhshëm nga Komiteti MONEYVAL*, njoftim institucional mbi procesin e përgatitjes së autoriteteve shqiptare për vlerësimin MONEYVAL, publikuar në faqen zyrtare të FIA-s.

Në deklaratën publike të FATF për daljen nga lista, përveç evidentimit të qartë të progresi të arritur dhe përgëzimit të Shqipërisë, evidentohet edhe se “FATF mirëpret angazhimin e Shqipërisë për të respektuar parimet e FATF në rast se Shqipëria prezanton një program amnistie fiskale në të ardhmen”, si dhe kërkon që Shqipëria “të vazhdojë të punojë me MONEYVAL për të mbështetur përmirësimet e saj në sistemin e saj PPP/FT”.

Në raportin e vlerësimit të Grupit të Përbashkët (Joint Group – JG) të ICRG/FATF, janë propozuar disa rekomandime, pavarësisht se nuk janë teknikisht të detyrueshme, por që duhet të mbahen në vëmendje nga Shqipëria në përmirësimin e mëtejshëm të sistemit parandalues të PP/FT dhe armëve të shkatërrimit në masë, si më poshtë vijon:

- Nëse Shqipëria do të hartojë në të ardhmen një program mbi amnistinë fiskale, JG inkurajon Shqipërinë të punojë me partnerët ndërkombëtarë për të siguruar që çdo program i tillë të jetë në përputhje me parimet dhe praktikën më të mira të FATF-së për programet e amnistisë fiskale (VTC programme).
- Inkurajohet Shqipëria të arrijë progres të mëtejshëm në ndjekjen e më shumë hetimeve penale dhe ngritjen e akuzave për veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale (pastrimin e parave) në lidhje me rreziqet e larta të identifikuar për pastrim parash, si korrupsioni, krimi i organizuar dhe trafikimi i narkotikëve, me fokus të veçantë rastet kur vepra penale mëmë të jetë kryer në juridiksion të huaj.
- Inkurajohet Shqipëria të arrijë progres të mëtejshëm nëpërmjet një koordinimi më të gjerë ndër-institucional për të vlerësuar kërcënimet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe për të zhvilluar politika dhe strategji për të adresuar këto kërcënime. SPAK duhet të përfshihet plotësisht në këto përpjekje.
- Kërkohet nga Shqipëria që të ngrejë dhe të zbatojë një sistem të menaxhimit të rasteve me qëllim zëvendësimin e sistemit aktual të përdorur nga prokurorët për të menaxhuar dhe ndjekur ecurinë e rasteve.
- Shqipëria duhet të investojë në burime, njerëzore dhe teknologjike, në luftën kundër kërcënimeve të reja në fushën e pastrimit të parave (p.sh., krimi kibernetik, asetet virtuale, etj.).

Rekomandimet e mësipërme janë pranuar nga organet shqiptare dhe janë tanimë pjesë e planeve të veprimit apo punës, sipas fushave përkatëse të përgjegjësisë.

Siç është e evidente nga këto rekomandime, fusha me potencial më të lartë shqetësues, përveç asaj për amnisti fiskale, është ajo që lidhet me ndjekjen penale. Në të njëjtin drejtim shkojnë edhe rekomandimet e BE në kuadër të raporteve të progresit, apo edhe mekanizmave të tjerë siç janë “Road map” dhe “Growth Agenda”.

Deri më sot, ligji në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit është ndryshuar disa herë (Ligji nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, ndryshuar me ligjin nr.10391, datë 3.3.2011; ligjin nr.66/2012, datë 7.6.2012; ligjin nr.44/2017, datë 6.4.2017; ligjin nr.33/2019, datë 17.6.2019, ligjin nr.120/2021, datë 2.12.2021; ligjin nr.62/2023, datë 21.7.2023), përfshirë edhe në funksion të qëllimit për përafrimin e legjislacionit përkatës me atë të BE.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*

- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Përshkrimi i problemit

Problemi konsiston në mangësitë dhe mospërputhjen e plotë të kuadrit ligjor në fuqi të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe armëve të dëmtimit në masë me kërkesat e *acquis* të BE-së, mangësi që çënojnë funksionimin efektiv të identifikimit të riskut, aksesit të AIF në informacionin dhe dokumentacionin e mbajtur në regjistrat publikë dhe nga autoritetet kompetente vendase, bashkëpunimin dhe koordinimin me autoritetet vendase kompetente dhe ato përkatëse të huaja dhe të BE, dhe në funksion të ligjzbatimit efektiv në mënyrë që sistemi financiar dhe operatorët financiarë dhe jofinanciarë të Shqipërisë të jenë jashtë përfshirjeve dhe trendeve të përfshirjes së Shqipërisë në pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit dhe të armëve të dëmtimit në masë.

Shtirja e mangësive të identifikuara prek të gjitha segmentet e sistemit të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit financiar dhe armëve të dëmtimit në masë, AIF dhe organet ligjzbatuese, mbikqyrësit e subjekteve raportuese, subjektet raportuese, etj. Mungesa e ndërhyrjeve efektive rrit ekspozimin ndaj veprimtarive të mundshme të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe të armëve të dëmtimit në masë.

Grupet e prekura nga ky Projektligj janë segmentet e sistemit publik dhe jopublik të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit financiar dhe të armëve të dëmtimit në masë, AIF dhe organet ligjzbatuese, mbikqyrësit e subjekteve raportuese, si Banka e Shqipërisë, AMF, IKA, Autoriteti i Mbikqyrjes së Lojërave të Fatit, Bordi i Mbikqyrjes Publike (auditorët, kontabilistët e miratuar dhe subjektet e tjera që licencon ky bord), Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Komiteti i Bashkërendimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, Ministria e Drejtësisë (Dhoma Kombëtare e Noterëve, Dhoma Kombëtare e Avokatisë, dhe ndërmjetësit e pasurive të paluajtshme dhe profesionistët e tjerë, etj.), subjektet raportuese, etj.

Natyra e problemit

Konstatohet se natyra e problemit kryesor është rregullator, pra, mungesa e përputhjes së plotë në të gjithë zërat e legjislacionit vendas në fuqi me *acquis* të BE, ku identifikohen mangësi thelbësore dhe jothelbësore.

Në lidhje me Direktivën (BE) 2024/1640 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 31 majit 2024 “Mbi mekanizmat që duhen vendosur nga Shtetet Anëtare për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit, që ndryshon Direktivën (BE) 2019/1937 dhe që ndryshon dhe shfuqizon Direktivën (BE) 2015/849”.

Mangësitë kryesore që justifikuan miratimin e AMLD6 të ri:

- Zbutja dhe rezistenca e pamjaftueshme e rrezikut: Korniza ligjore 2015/849 nuk ishte më e mjaftueshme për të zbutur në mënyrë efektive rreziqet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, për të zbuluar keqpërdorimin kriminal të sistemit financiar ose për të siguruar qëndrueshmërinë dhe integritetin e tregut të brendshëm.
- Mbikëqyrje e dobët dhe jokonsistente: Mbikëqyrje përgjithësisht e dobët e subjekteve të detyruara, cilësi dhe mbikëqyrje e pamjaftueshme e organeve vetërregulluese dhe mungesë qartësie në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e mbikëqyrësve.
- Vlerësime të pamjaftueshme të rrezikut: Mungesa e koordinimit sistematik mbi rreziqet ndërkufitare; vlerësimet kombëtare të rrezikut nuk mbulonin subjektet/marrëveshjet ligjore (përfshirë ato të huaja), rreziqet e shmangies së sanksioneve, skemat e rezidencës së investitorëve ("vizat e arta"), pasuritë e paluajtshme dhe IBAN-et virtuale
- Mangësitë në transparencën e pronësisë përfituese: Rregulla të paqëndrueshme, cilësi e dobët e të dhënave, verifikim i dobët, regjime të ndryshme të aksesit dhe pasiguri ligjore pasi Gjykata e Drejtësisë anuloi dispozitën e aksesit publik. Nuk ka rregulla uniforme mbi të nominuarit, subjektet e huaja ose shqyrtimin e sanksioneve.

- Kufizime mbi FIU-të: Ndryshime të konsiderueshme në kompetenca, akses në informacion dhe bashkëpunim; akses i vonuar në të dhënat bankare, të letrave me vlerë, të krypto-aseteteve dhe të pasurive të paluajtshme; kompetenca të pamjaftueshme pezullimi dhe monitorimi; dhe analizë e dobët e përbashkët ndërkufitare.
- Sanksione/zbatim i paqëndrueshëm dhe joefektiv: Divergjencë e gjerë në sanksionet financiare dhe masat administrative, pa një përkufizim të përbashkët të shkeljeve "serioze" dhe efekt të pamjaftueshëm dekurajues.
- Probleme të tjera: Mungesa e pikave qendrore të kontaktit për disa ofrues ndërkufitarë, statistika të dobëta dhe mekanizma të paqartë bashkëpunimi midis mbikëqyrësve, NJIF-ve dhe autoriteteve të tjera.

Në kuadër të përafrimit me acquis të Bashkimit Evropian është synuar transpozimi me dispozitat e Direktivës 2024/1640 dhe përafrimi i plotë i legjislacionit AML/CFT dhe, në veçanti, i ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit” duke rregulluar dhe garantuar që Shteti Shqiptar të operojë me standarde të njëjta, mekanizma efektivë dhe bashkëpunim të detyrueshëm në nivel Evropian. Nga ky transpozim transformohen elemente, si funksionimi i AIF, rritja e kapaciteteve të mbikëqyrjes, forcimi i mbrojtjes së subjekteve raportuese, harmonizimi i të gjithë arkitekturës kombëtare me modelin e ri evropian të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe armëve të dëmtimit në masë, etj.

Për qëllime të transpozimit të plotë të Direktivës (BE) 2024/1640, është hartuar Tabela e Përputhshmërisë (ToC) përkatëse dhe, nga krahasimi midis dispozitave të Direktivës me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe, specifikisht, me ligjin “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit”, i ndryshuar, midis të tjerave janë identifikuar këto mangësi ligjore:

- Së pari, në legjislacionin në fuqi mungojnë një sërë përkufizimesh të koncepteve bazë që trajtohen në fushëzbatimin e ligjit AML/CFT, përfshirë por pa u kufizuar në: “mbikëqyrës financiar”, “mbikëqyrës jo financiar”, “autoritet kompetent”, “shtet i origjinës”, “shtet pritës”, “autoritet doganor”, “kolegj mbikëqyrës PPP/FT”, “financim i përhapjes së armëve në masë”, “AMLA”, etj.
- Së dyti, fushëzbatimi të ligjit në fuqi është më i kufizuar pasi parashikohet rregullim i një grup subjektsh të detyruara ku përfshihen bankat, institucionet financiare jo banka dhe disa profesione të lira, ndërkohë që janë të papërfshira një sërë subjektsh që korrespondojnë me zhvillimet e reja në tregun financiar, duke përfshirë këtu ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve, fintech dhe shërbimet dixhitale dhe strukturat e reja të ndërmjetësimit financiar, subjekte të tjera, etj.
- Së treti, në legjislacionin në fuqi mungon qasja e mirëfilltë e përcaktimit të masave efektive kundër AML/CFT bazuar në kriterin e rrezikut (Risk-Based Approach), një kriter i domosdoshëm jo vetëm për ndarjen e subjekteve në kategori të rrezikut të ulët, të mesëm apo të lartë, por mbi të gjitha për përcaktimin e masave ndëshkuese për subjektet respektive.
- Së katërti, janë evidentuar mangësi në identifikimin e përfituesit përfundimtar, çka do të thotë që koncepti i personave fizikë që veprojnë brenda një personi juridic, p.sh në formën e një banke apo institucioni tjetër financiar, mekanizmi i vlerësimit nuk është i detajuar dhe nuk ka mekanizma reale të verifikimit, ndërkohë që, me Projektligjin futen mekanizma të rinj të vlerësimit të vazhdueshëm lidhur me integritetin dhe reputacionin (fit and proper) edhe pas një periudhe të caktuar nga momenti i akreditimit fillestar profesional. Kjo realizohet me Projektligjin, në rradhë të parë, përmes masave parandaluese, si aksesin në regjistra, transparencën në shkëmbimin e informacionit, përmirësimi i bashkëpunimit ndërinstitucional, por edhe nga masat ndëshkuese, si heqja apo revokimi i licencës së subjekteve juridike që kanë detyrim raportimin tek autoritetet kompetente dhe marrjen e masave për ndëshkim.
- Së pesti, lidhur me transparencën në shkëmbimin e informacionit dhe aksesin në të dhënat e regjistrave është hasur mangësi ligjore pasi, jo vetëm që në ligjin në fuqi mungon rregullimi i aksesit në regjistra të veçantë por, mbi të gjitha, aksesin është i kufizuar dhe nuk ekziston një regjistër qendror unik që të mbajë të dhënat dhe të jetë i aksesueshëm në kuadër të të ashtuquajturës “single access point” për shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin ndërinstitucional vendas e të huaj. Tashmë, me Projektligjin është parashikuar detyrimi për një pikë të vetme kontakti ku aksesin

është i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm në informacionin përkatës bazuar në provueshmërinë e interesit të ligjshëm.

- Së gjashti, bashkëpunimi ndërinstitutional dhe ndërkombëtar në ligjin në fuqi është i parashikuar si një koncept dhe i trajtuar ngushtë përmes një dispozite, duke mos pasur mekanizma të detajuar efektive të bashkëpunimit, kriteret, procedura, mënyra, afate apo një strukturë të ndihmës së ndërsjellë reciproke, vendas dhe të huaj.
- Së shtati, vihen re mangësi në përdorimin e burimeve teknike dhe administrative me një teknologji më të kufizuar dhe aspekti kryesor ku del në pah kjo mangësi është mbrojtja e të dhënave gjatë shkëmbimit të informacionit të kërkuar në kuadër të masave AML/CFT duke mos pasur një sistem të dixhitalizuar dhe të gjurmueshëm të kontrollit mbi të dhëna. Kjo mangësi rregullohet në Projektligj përmes dispozitave lidhur me “data governance”.
- Së teti, mangësia lidhur me regjimin e sanksioneve është evidente pasi ligji në fuqi ka një regjim të dobët sanksionesh të cilat në praktikë sjellin problematika madhore pasi sanksionet ‘gjyba’ të një vlere relativisht të vogël konsiderohen nga subjektet juridike, si kosto operative, duke i shtyrë këto të fundit në ripërsëritje të vazhdueshme të shkeljeve. Problematika kryesore këtu qëndron tek moszbatimi i proporcionalitetit të sanksioneve dhe i kontrollit të vazhdueshëm. Në lidhje me këtë, Projektligji parashikon edhe sanksione të cilat, në kuadër të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe armëve të dëmtimit në masë, mund të vihen edhe nga organet mbikqyrëse, përveç AIF.
- Së nënti, në ligjin në fuqi mungon koncepti i rrezikut dhe parandalimit të armëve të dëmtimit në masë. Në Projektligj është shtuar edhe koncepti i rrezikut dhe parandalimit të financimit të ‘armëve të dëmtimit në masë’ në kushtet e rrezikshmërisë shoqërore krahas parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe armëve të dëmtimit në masë.
- Së dhjeti, në ligjin në fuqi mungojnë dispozita të shprehura në lidhje me vlerësimet kombëtare e sektoriale periodike. Në Projektligj është shtuar edhe kërkesa për kryerjen e vlerësimeve kombëtare e sektoriale periodike.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria e sheh të nevojshme të ndërhyjë.*
 - *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
 - *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Në Forumin Ministror BE–Ballkan Perëndimor për Drejtësinë dhe Çështjet e Brendshme, i mbajtur në Sarajevë më 30-31 tetor 2025, përfaqësuesit e Bashkimit Evropian dhe të vendeve të Ballkanit Perëndimor nënshkruan Planin e Përbashkët të Veprimit për Parandalimin dhe Luftën kundër Terrorizmit dhe Ekstremizmit të Dhunshëm për Ballkanin Perëndimor (2025). Sipas objektivit përkatës të këtij Plani, Shqipëria riafirmoi angazhimin e saj në harmonizimin e legjislacionit të saj me Direktivat dhe Rregulloret e BE-së, duke vazhduar bashkëpunimin e nisur me Planin të Përbashkët të Veprimit të vitit 2018.

“Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit 2024-2030” dhe Plani i Veprimit parashikon objektiva strategjike dhe masa operationale konkrete për autoritetet shqiptare në parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, e mbi të gjitha përafrimin e plotë të legjislacionit shqiptar me atë të BE-së.

Sipas pikës 3.2 të “Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit 2024-2030”, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1, datë 24.07.2024, Shqipëria mbetet e angazhuar në adresimin e sfidave dhe rekomandimeve që rrjedhin si pasojë e detyrimeve ndërkombëtare që lidhen me parandalimin dhe luftën ndaj PP/FT. Gjithashtu, në koordinim dhe harmonizim edhe me planet dhe strategjitë e tjera sektoriale të sigurisë kombëtare, luftës ndaj krimit të organizuar, korrupsionit, terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm, informalitetit etj., janë adresuar dhe do vijohet të adresohen një sërë mangësish, duke arritur rezultate të prekshme dhe konkrete.

Në zbatim të SKZHIE 2022-2030 dhe strategjive të tjera e planeve të veprimit që ndërthuren me këtë strategji, është miratuar Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2024–2026, si dhe Dokumenti i Politikave Prioritare 2025-2027. Në dokumentin e politikave prioritare për vitet 2025-2027, ritheksohet se Qeveria është e vendosur të kryejë përpjekje të qëndrueshme në lidhje me prioritetet kyçe që kanë të bëjnë me reformën gjyqësore, politikën kundër korrupsionit, luftën kundër krimit të organizuar, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe reformën në administratën publike si prioritate në kuadër të negociatave të grup kapitujve themelorë dhe atyre të aderimit në përgjithësi. Procesi i adresimit të problematikave dhe mangësive do vijojë të ketë vëmendje të posaçme nga Qeveria si dhe organet e pavarura (hetimore, mbikëqyrës etj), duke synuar përputhshmërinë maksimale ligjore dhe rritje të mëtejshme të efektivitetit me rekomandimet dhe detyrimet e tjera ndërkombëtare të Shqipërisë.

Deri më sot, ligji në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (Ligji nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, ndryshuar me ligjin nr.10391, datë 3.3.2011; ligjin nr.66/2012, datë 7.6.2012; ligjin nr.44/2017, datë 6.4.2017; ligjin nr.33/2019, datë 17.6.2019, ligjin nr.120/2021, datë 2.12.2021; ligjin nr.62/2023, datë 21.7.2023) është ndryshuar disa herë, përfshirë edhe në funksion të qëllimit për përafrimin e legjislacionit me atë të BE. Në këto kushte, dhe duke qenë se Shqipëria është në prag të anëtarësimit në BE (2030), mirëpritet nga të gjitha palët përkatëse dhe të interesuara, që Shqipëria të ketë një ligj të ri të vetëm të posaçëm për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit dhe armëve të dëmtimit në masë, i cili përkon me Opsionin 1 të sipërshkruar.

Në këtë kuptim, deri tani, në kuadrin ligjor shqiptar evidentohen mungesa në lidhje me përafrimin me legjislacionin e BE, specifikisht, konstatohen mangësi dhe mospërputhje ose mospërputhje pjesore me Direktivën nr.2024/1640, datë 31 maj 2024 “Për mekanizmat që duhet të vendosen nga Shtetet Anëtare për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit”, e cila ka ndryshuar Direktivën (BE) 2019/1937, si dhe ka ndryshuar dhe shfuqizuar Direktivën (BE) 2015/849, dhe Rregulloren nr.2024/1624, datë 31 maj 2024 “Për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit”, dhe Rregulloren nr.2023/1113, datë 31 maj 2023 “Për informacionin që shoqëron transfertat e fondeve dhe disa aktiveve krypto, si dhe për ndryshimin e direktivës nr. 2015/849”.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat e vendosur të korrespondojnë me ato të dhëna në përmbledhjen ekzekutive, por më të detajuara.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

1. Përafrimi i plotë me acquis të BE-së - Harmonizimi i plotë i kuadrit ligjor shqiptar me acquis të BE-së në fushën PP/FT, duke integruar tërësisht dispozitat e AMLD6 dhe akteve përkatëse zbatuese, nëpërmjet ndryshimeve ligjore dhe koordinimit ndërinstitutional.

2. Përmbushja e rekomandimeve të FATF/MONEYVAL - Zbatimi i masave për adresimin e rekomandimeve të FATF/MONEYVAL, duke reflektuar edhe ndryshimet e viteve 2024–2025, me synim përmirësimin e treguesve në ciklin e ardhshëm të vlerësimit.

3. Zvogëlimi i rreziqeve të PP/FT përmes politikave dhe bashkëpunimit - Reduktimi i rreziqeve kombëtare të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit nëpërmjet forcimit të politikave, koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstitutional.

4. Parandalimi dhe raportimi i produkteve të krimit dhe fondeve terroriste - Forcimi i mekanizmave të identifikimit, verifikimit dhe raportimit nga subjektet raportuese për të parandaluar hyrjen dhe qarkullimin e fondeve të paligjshme në sistemin financiar.

5. Zbulimi dhe goditja e kërcënimeve të PP/FT - Rritja e kapaciteteve analitike dhe operacionale për identifikimin dhe goditjen e skemave të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

6. Rregullimi i sektorëve të rinj me rrezik të lartë - Vendorsja e një kuadri të qartë rregullator për ofruesit e shërbimeve të mjeteve virtuale dhe transfertat e krypto-aseteve.

7. Forcimi i bashkëpunimit ndërinstytucional dhe ndërkombëtar - Përmirësimi i mekanizmave të shkëmbimit të informacionit ndërmjet autoriteteve kombëtare dhe atyre ndërkombëtare (BE, AMLA, etj.).

8. Përmirësimi i sistemit të monitorimit dhe analizës së rrezikut - Zhvillimi i një qasjeje më të avancuar të bazuar në rrezik, duke përdorur vlerësimin kombëtar dhe analizat sektoriale.

9. Rritja e efektivitetit të sanksioneve dhe masave administrative - Vendorsja e një sistemi sanksionesh më të qarta, proporcionale dhe parandaluese për shkeljet e kuadrit PP/FT.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë identifikuar opsionet e politikës.*

Opsioni 0 / Status quo: vijimi me ligjin aktual, me Ligjin nr.9917, datë 19.05.2008 “*Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit*”, i ndryshuar. Megjithatë, duke qenë se në kuadrin ligjor shqiptar evidentohen boshllëqe në drejtim të përafrimit të plotë me legjislacionin e BE-së, si dhe kufizime në adresimin e risqeve të reja (p.sh. krypto-asetet, transparencja e pronësisë përfituese, mekanizmat e avancuar të bashkëpunimit), ky opsion nuk mund të konsiderohet si i përshtatshëm për përmbushjen e objektivave që rrjedhin nga procesi i integritetit evropian dhe detyrimet ndërkombëtare.

Avantazhet

- **Stabilitet rregullator afatshkurtër:** Ruhet kuadri ekzistues pa krijuar pasiguri ose kosto tranzicioni për subjektet e detyruara dhe institucionet.
- **Kosto minimale financiare dhe administrative:** Nuk kërkohen burime shtesë për hartimin dhe zbatimin e ndryshimeve ligjore apo për adaptimin institucional.
- **Lehtësim për subjektet e detyruara në afat të shkurtër:** Shmanget nevoja për përshtatje me kërkesa të reja ligjore, procedura apo sisteme raportimi.

Disavantazhet

- **Mospërputhje me acquis të BE-së:** Nuk sigurohet harmonizimi me direktivat dhe rregulloret e fundit të BE-së (AMLD6, AMLA), duke penguar progresin në procesin e integritetit evropian.
- **Mosadresim i rekomandimeve të FATF/MONEYVAL:** Rrezikohet përkeqësimi i vlerësimit ndërkombëtar dhe rritja e riskut reputacional për vendin.

- **Mangësi në adresimin e rrezeve të reja:** Kuadri aktual nuk përfshin në mënyrë të plotë zhvillimet e reja si krypto-asetet, strukturat komplekse të pronësisë apo teknikat moderne të pastrimit të parave.
- **Efektivitet i kufizuar i sistemit PP/FT:** Mekanizmat aktualë të analizës, raportimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional mbeten të pjesshëm dhe më pak eficientë krahasuar me standardet e reja.

Opsioni 1 (jorregullator):- nënkupton marrjen e masave jorregullatore si kryerja e fushatave ndërgjegjëse dhe rritja e kontrolleve

Ky opsion konsiston në ndërmarrjen e masave jorregullatore, si organizimi i fushatave ndërgjegjëse për subjektet e detyruara dhe publikun, si dhe rritja e kontrolleve dhe monitorimit nga autoritetet kompetente, pa ndryshuar kuadrin ligjor ekzistues.

Avantazhet

- **Kosto relativisht e ulët:** Nuk kërkon ndryshime ligjore apo reforma të thella institucionale, duke reduktuar barrën financiare dhe administrative.
- **Zbatim i shpejtë:** Masat si trajnime, udhëzime dhe fushata ndërgjegjëse mund të implementohen menjëherë.

Disavantazhet

- **Nuk adreson boshllëqet ligjore:** Mangësitë strukturore të kuadrit aktual (sidomos në raport me acquis të BE-së) mbeten të pandryshuara.
- **Përafrim i pamjaftueshëm me standardet ndërkombëtare:** Nuk siguron harmonizim me paketën e re AML të BE-së dhe rekomandimet e përditësuara të FATF.
- **Ndikim afatshkurtër:** Efektet e fushatave ndërgjegjëse mund të jenë të përkohshme dhe të mos çojnë në ndryshime të qëndrueshme strukturore.
- **Nuk garanton arritjen e objektivave të reformës:** Ky opsion nuk mundëson përmbushjen e objektivave strategjike, veçanërisht në drejtim të integritetit evropian dhe përmirësimit të vlerësimeve ndërkombëtare.

Opsioni 2 – Ndryshimi i ligjit në fuqi

Ky opsion konsiston në ndryshimin e ligjit ekzistues nr. 9917/2008 nëpërmjet amendimeve të shumta dhe të thelluara, me qëllim përafrimin me acquis të BE-së dhe standardet ndërkombëtare. Megjithëse synon përmirësimin e kuadrit aktual, ai bazohet mbi një strukturë ligjore ekzistuese që nuk është ndërtuar fillimisht në përputhje me arkitekturën e re evropiane.

Avantazhet

- **Përmirësim i ndjeshëm i kuadrit aktual:** Mundëson adresimin e një pjese të konsiderueshme të mangësive ekzistuese pa kaluar në një ligj tërësisht të ri.
- **Kosto më e moderuar se një ligj i ri:** Krahasuar me hartimin e një kuadri të ri nga e para, kërkon më pak burime financiare dhe institucionale.
- **Vazhdimësi juridike dhe institucionale:** Ruhet baza ekzistuese, duke shmangur një “shkëputje” të menjëhershme nga sistemi aktual.

Disavantazhet

- **Strukturë ligjore e fragmentuar dhe e mbivendosur:** Ndryshimet e shumta mbi një ligj të vjetër krijojnë një tekst të komplikuar, me rrezik për paqartësi interpretimi dhe zbatim jo uniform.
- **Përafrim jo i plotë me acquis të BE-së:** Ligji ekzistues nuk përputhet plotësisht me qasjen e re të BE-së (AML package), duke e bërë të vështirë harmonizimin e plotë vetëm përmes amendimeve.
- **Mosadresim i plotë i reformës strukturore:** Ky opsion nuk lejon rindërtimin e sistemit mbi parime të reja (p.sh. qasje e integruar, rol i AMLA, mekanizma të rinj të bashkëpunimit).
- **Kompleksitet në zbatim:** Subjektet dhe autoritetet përballen me një kuadër të ndryshuar pjesërisht, shpesh më të vështirë për t'u interpretuar sesa një ligj i ri i strukturuar qartësisht.
- **Efektivitet më i kufizuar në afatgjatë:** Ndryshimet inkrementale nuk garantojnë një sistem modern dhe plotësisht funksional sipas standardeve të reja ndërkombëtare.

Opsioni 3 – Hartimi dhe miratimi i një ligji të ri

Ky opsion konsiston në hartimin dhe miratimin e një ligji të ri tërësor për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, i ndërtuar nga baza mbi parimet dhe kërkesat e acquis të BE-së (AMLD6, AML package) dhe standardet e FATF. Ky kuadër i ri synon të krijojë një strukturë moderne, të integruar dhe koherente, duke adresuar në mënyrë të plotë mangësitë e identifikuara në legjislacionin ekzistues dhe duke reflektuar zhvillimet më të fundit në këtë fushë.

Avantazhet

- **Përafrim i plotë dhe i qëndrueshëm me acquis të BE-së:** Siguron harmonizim të plotë me kuadrin e ri evropian dhe përmbush kërkesat e procesit të integritetit.
- **Qasje e re dhe e integruar ligjore:** Ndërtim i një sistemi të ri, të strukturuar dhe koherent, duke shmangur fragmentimin dhe mbivendosjet.
- **Adresim i plotë i mangësive ekzistuese:** Zgjidh në mënyrë gjithëpërfshirëse boshllëqet ligjore dhe institucionale të identifikuara.
- **Përfshirje e rrezeve dhe zhvillimeve të reja:** Rregullon në mënyrë të plotë krypto-asetet, transfertat digjitale, transparencën e pronësisë përfutuese dhe mekanizmat modernë të kontrollit.
- **Rritje e efektivitetit të sistemit PP/FT:** Forcon rolin e institucioneve, analizën financiare, raportimin dhe bashkëpunimin ndërinstitucional dhe ndërkombëtar.
- **Përmirësim i rezultateve në FATF/MONEYVAL:** Ndikon pozitivisht në vlerësimet ndërkombëtare.
- **Rritje e besimit dhe integritetit të sistemit financiar:** Përmirëson transparencën, sigurinë dhe klimën e investimeve.

Disavantazhet

- **Kosto fillestare më e lartë:** Kërkon burime të konsiderueshme për hartim, konsultim, miratim dhe zbatim (administrativ dhe financiar).
- **Nevojë për përshtatje të gjerë nga subjektet e detyruara:** Subjektet duhet të përshtasin procedurat, sistemet dhe kapacitetet e tyre me kërkesat e reja.
- **Ngarkesë për institucionet publike:** Kërkohej rritje e kapaciteteve njerëzore, teknike dhe organizative.

Pavarësisht kostove dhe sfidave afatshkurtra, ky opsion garanton një **reformë të plotë, koherente dhe të qëndrueshme** të sistemit të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Për këtë arsye,

ai konsiderohet **opsioni i preferuar**, pasi siguron përmbushjen e objektivave strategjike, harmonizimin me acquis të BE-së dhe rritjen e efektivitetit të kuadrit ligjor në afatgjatë.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*
 - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe rreziqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 - *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*
 - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*
 - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
 - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
 - *Paraqisni përlllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*

Me synimin përfundimtar për përafrimin e plotë të legjislacionit, dhe duke qenë se praktika legjislative tregon se, nëse ka më shumë se 10 ndryshime të tilla, procedohet me hartimin e një Ligji të Ri, kjo qasje është më e përshtatshme edhe në këtë rast, pasi është i nevojshëm harmonizimi me Direktivën VI kundër Pastrimit të Parave (BE) 2024/1640, Rregulloren e BE-së 2024/1624 dhe Rregulloren e BE-së 2023/1113.

Hartimi i një ligji të ri / ligj i posaçëm, është një mundësi për të përmbushur qëllimin për krijimin e një kuadri rregullator të plotë të posaçëm dhe të përafruar plotësisht me atë të BE. Përfshirja në një ligj të ri të vetëm do të mundësonte përmbajtjen në një ligj të vetëm, i lehtë për t'u zbatuar, i cili përfshin të gjitha elementet e kërkuara nga Direktiva nr.2024/1640, datë 31 maj 2024 “Për mekanizmat që duhet të vendosen nga Shtetet Anëtare për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit”, e cila ka ndryshuar Direktivën (BE) 2019/1937, si dhe ka ndryshuar dhe shfuqizuar Direktivën (BE) 2015/849, dhe Rregulloren nr.2024/1624, datë 31 maj 2024 “Për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit” dhe Rregulloren nr.2023/1113, datë 31 maj 2023 “Për informacionin që shoqëron transfertat e fondeve dhe disa aktiveve krypto, si dhe për ndryshimin e Direktivës nr.2015/849”.

Ligji i ri rregullon mangësitë e kuadrit ligjor në fuqi të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe armëve të dëmtimit në masë me kërkesat e acquis të BE-së, mangësi që çenojnë funksionimin efektiv të identifikimit të riskut, aksesit të AIF në informacionin dhe dokumentacionin e mbajtur në regjistrat publikë dhe nga autoritetet kompetente vendase, bashkëpunimin dhe koordinimin me autoritetet vendase kompetente dhe ato përkatëse të huaja dhe të BE, dhe në funksion të ligjzbatimit efektiv në mënyrë që sistemi financiar dhe operatorët financiarë dhe jofinanciarë të Shqipërisë të jenë jashtë përfshirjeve dhe trendeve të përfshirjes së Shqipërisë në pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit dhe të armëve të dëmtimit në masë.

Hartimi dhe miratimi i një ligji të ri të vetëm do të sigurojë edhe ndjekjen dhe përsosjen në metoda të AIF dhe organet e tjera të inteligjencës financiare, etj., lidhur me zhvillimet më të fundit në tregun financiar dhe atë jofinanciar përkatës, përfshirë por pa u kufizuar në, zhvillimet përkatëse të shërbimeve e produkteve financiare dixhitale, zhvillimeve teknologjike, etj., dhe kjo mundësohet vetëm me një ligj të ri të integruar.

Ligji i ri rregullon shtrirjen e mangësive të identifikuar të cilat prekin të gjitha segmentet e sistemit të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit financiar dhe armëve të dëmtimit në masë, AIF dhe organet ligjzbatuese, mbikqyrësit e subjekteve raportuese, subjektet raportuese, etj., dhe përshtatjen e ndërhyrjeve lidhur me zhvillimet më të fundit në tregun financiar dhe atë jofinanciar përkatës (zhvillimet e shërbimeve e produkteve financiare dixhitale, zhvillimeve teknologjike, etj.) dhe mungesa e ndërhyrjeve efektive rrit ekspozimin ndaj veprimtarive të mundshme të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe armëve të dëmtimit në masë.

Grupet që preken nga ky Projektligj janë segmentet e sistemit të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit financiar dhe armëve të dëmtimit në masë, Banka e Shqipërisë, AMF, IKA, Autoriteti i Mbikqyrjes së Lojërave të Fatit, Bordi i Mbikqyrjes Publike (auditorët, kontabilistët e miratuar dhe subjektet e tjera që licencon ky bord), Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Komiteti i Bashkërendimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, Ministria e Drejtësisë (Dhoma Kombëtare e Noterëve, Dhoma Kombëtare e Avokatisë, dhe ndërmjetësit e pasurive të paluajtshme dhe profesionistët e tjerë, etj.), subjektet raportuese, etj.

Ndikimi social

Përafrimi i legjislacionit shqiptar në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit me Direktivën (BE) 2024/1640, Rregulloren (BE) 2024/1624 dhe Rregulloren (BE) 2023/1113 pritet të ketë një ndikim të ndjeshëm dhe pozitiv në jetën shoqërore dhe ekonomike të vendit. Ky proces përafrimi synon forcimin e kuadrit ligjor dhe institucional për mbrojtjen e interesit publik, si dhe rritjen e efektivitetit të mekanizmave shtetërorë për parandalimin dhe goditjen e veprimtarive kriminale financiare.

Zbatimi i standardeve të harmonizuara evropiane do të kontribuojë në rritjen e transparencës dhe integritetit në veprimtarinë ekonomike, duke kufizuar mundësitë për abuzim me sistemin financiar, si dhe për fshehjen e pasurive me origjinë të paligjshme.

Qytetarët dhe bizneset që respektojnë standardet ligjore do të përfitojnë nga një mjedis më i drejtë dhe më konkurrues, duke ndikuar kështu drejtpërdrejtë në funksionimin e shtetit të së drejtës.

Përmirësimi i mekanizmave për identifikimin e dërguesve të transfertave, transparenca në lidhje me pronarët përfitues dhe gjurmimi i transfertave financiare, përfshirë ato që lidhen me asetet krypto, do të ndikojë në formalizimin e mëtejshëm të marrëdhënieve ekonomike dhe do të rrisë sigurinë financiare për qytetarët.

Ligji i ri pritet të ketë ndikim pozitiv në luftën kundër korrupsionit, krimit të organizuar dhe formalizimin e tregut.

Përafrimi i legjislacionit vendas me 3 (tre) aktet ligjore evropiane do të përbëjë një hap të rëndësishëm drejt forcimit të shtetit të së drejtës dhe rritjen e besimit qytetar përballë institucioneve publike. Gjithashtu, ky ligj do të përmirësojë / reflektojë angazhimin e Shqipërisë në zbatimin e standardeve ndërkombëtare në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe armëve të dëmtimit në masë.

Reforma pritet të ketë një ndikim të përgjithshëm pozitiv shoqëror përmes forcimit të sundimit të ligjit, reduktimit të infiltrimit kriminal në ekonomi, përmirësimit të besimit në institucione dhe krijimit të kushteve më të drejta të tregut. Efektet e mundshme negative afatshkurtra lidhen kryesisht me rritjen e detyrimeve të pajtueshmërisë dhe barrën administrative për subjektet raportuese dhe klientët, të cilat duhet të zbuten përmes zbatimit proporcional, udhëzimeve specifike për sektorin dhe mbikëqyrjes së bazuar në risk.

Përafrimi i legjislacionit shqiptar me legjislacionin e BE-së në fushën e pastrimit të parave dhe parandalimit të financimit të terrorizmit dhe armëve të dëmtimit në masë pritet, që në mënyrë indirekte të ketë efekte pozitive në aspektin mjedisor.

Miratimi i një kuadri të ri ligjor të përafruar me direktivën përkatëse dhe dy rregulloret e BE në këtë fushë do të nxisë përdorimin e teknologjisë, proceseve digjitale, shkëmbimin elektronik të të dhënave dhe automatizimin e sistemeve raportuese, duke reduktuar prodhimin e dokumentacionit fizik.

Ndikimi mjedisor i reformës pritet të jetë i kufizuar dhe kryesisht indirekt. Një efekt modest pozitiv pritet përmes dixhitalizimit të raportimit, shkëmbimit të të dhënave dhe aksesit në regjistra, duke zvogëluar proceset në letër dhe disa lëvizje administrative. Çdo rritje në përdorimin e infrastrukturës së TIK-ut nuk pritet të jetë aq e rëndësishme sa të krijojë një ndikim negativ material në mjedis.

Harmonizimi i procedurave për kujdesin e duhur ndaj klientit, raportimin e transaksioneve dhe gjurmimi i transfertave financiare, përfshirë ato të aseteve krypto, do të kontribuojë në uljen e përdorimit të letrës, në optimizimin e proceseve administrative dhe në reduktimin e ndikimit mjedisor nga veprimtaria e institucioneve financiare. Kjo qasje është në përputhje me parimet e tranzicionit digjital dhe të ekonomisë së qëndrueshme të promovuara nga BE. Në tërësi, ky përafrim kontribuon në krijimin e një administrate dhe tregu financiar më efikas dhe më të përgjegjshëm ndaj mjedisit, në përputhje me politikat mjedisore dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të Bashkimit Evropian.

Ndikimi ekonomik

Projektligji pritet të ketë një ndikim ekonomik pozitiv në afat të mesëm dhe afatgjatë. Në termin afat - shkurtër, ndikimi ekonomik i Projektligjit lidhet kryesisht me kostot e përshtatjes institucionale, teknike dhe administrative, si në sektorin publik edhe atë privat. Në terma afat mesëm dhe afatgjatë, përfitimet pritet të jenë më të mëdha, pasi forcimi i sistemit të parandalimit të pastrimit të parave ndikon në rritjen e integritetit financiar, reduktimin e ekonomisë informale, mbrojtjen e konkurrencës së ndershme dhe përmirësimin e reputacionit ndërkombëtar të vendit.

Kostot dhe përfitimet ekonomike të Projektligjit mund të ndahen në disa kategori kryesore.

1. Projektligji krijon ***kosto administrative dhe institucionale*** për autoritetet publike përgjegjëse për zbatimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e tij, pasi ato do të duhet të forcojnë kapacitetet njerëzore, teknike dhe organizative. Parashikohet kostoja për përditësimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit. AIF do të duhet të realizojë modifikime të sistemit të IT-se duke shtuar module të reja si pasoje e funksionaliteteve të reja për raportimin elektronik, shkëmbimin e informacionit, ruajtjen e të dhënave dhe sigurinë e informacionit.

3. Projektligji ***do të krijojë kosto për bizneset*** (subjektet e detyruara të raportojnë si bankat, institucionet financiare, ofruesit e shërbimeve të pagesave, noterët dhe institucionet jo-finance) të cilët do të duhet të përditësojnë politikat, procedurat dhe kontrollat e brendshme. Kostot kryesore fillestare pas hyrjes në fuqi të ligjit lidhen me nevojën për forcim kapacitetesh, përditësim të sistemeve të teknologjisë së informacionit, mbikëqyrje dhe përputhshmëri nga subjektet e raportuese. Këto janë kryesisht kosto të familjarizimit, të përshtatjes me kërkesat e reja ligjore që do të vinë nga projekt-ligji dhe zbatimit të tij, që lidhet më kostot e verifikimit të dokumentacionit të transaksioneve dhe raportimet periodike prane strukturave monitoruese dhe kontrolluese të sbatimit të ligjit. Për subjektet me kapacitete më të kufizuara administrative dhe financiare, kërkesat për raportim, kontrole të brendshme, trajnime dhe përputhshmëri mund të jenë më të vështira për t'u përballuar se sa për institucionet e mëdha financiare.

Gjithashtu për bizneset dhe qytetarët për shkak të kërkesave më të forta të verifikimit të dokumentacionit si dhe verifikimi i burimit të fondeve mund të sjellin rritje të dokumentacionit të kërkuar dhe, në disa raste, vonesa në kryerjen e transaksioneve.

Megjithatë, këto kosto duhet të vlerësohen në raport me natyrën parandaluese të Projektligjit dhe me nevojën për të mbrojtur sistemin financiar dhe ekonominë nga përdorimi i fondeve me origjinë të paligjshme.

Por përveç kostove fillestare dhe të raportimit, zhvillimi i moduleve të reja të sistemit të IT-se nga AIF do të sjelli ***edhe përfitime ekonomike për institucionet e administrates publike si edhe subjektet raportuese*** pasi do ta bëjë procesin e raportimit on-line duke shkurtuar kohën e procesimit të informacionit që verifikohet dhe kohës së raportimit, duke qënë se operacionet do të kryhen të gjitha on-line dhe paper-less.

Ndërsa në ***aspektin makro përfitimet ekonomike lidhen direkt me forcimin e integritetit të sistemit financiar***, pasi ul rrezikun që sistemi bankar dhe financiar të përdoret për pastrim parash, financim terrorizmi ose financim të aktiviteteve të tjera të paligjshme. Projektligji do të kontribuojë në formalizimin e ekonomisë përmes kontrollit më të mirë mbi transaksionet, burimin e fondeve dhe pronësinë përfituese duke ndihmuar në kufizimin e përdorimit të parave të padeklaruara dhe aktivitetit ekonomik informal

Mbrojtja e konkurrencës së ndershme, si rezultat i forcimit të kontrollit të transaksioneve nga bizneset që përdorin fonde të paligjshme mund të deformojnë tregun ndikon në krijimin e kushteve më të barabarta për operatorët ekonomikë. Gjithë këto masa ndikojnë më pas direkt në përmirësimin e klimës së investimeve, pasi ul perceptimin e riskut të lidhur me korrupsionin, krimin financiar, informalitetin dhe mungesën e transparencës në ekonomi.

Për këtë arsye, edhe pse Projektligji mund të sjellë kosto fillestare për administratën publike dhe subjektet e raportuese, këto kosto konsiderohen të justifikuara në raport me përfitimet ekonomike, institucionale dhe shoqërore që pritet të sjellë zbatimi efektiv i tij.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Opsioni 3

Hartimi i një ligji të ri është një mundësi për të përmbushur qëllimin për krijimin e një kuadri rregullator të plotë të posaçëm dhe të përafëruar plotësisht me atë të BE-së. Përfshirja në një ligj të ri të vetëm do të mundësonte përmbajtjen në një ligj të vetëm, i lehtë për t'u zbatuar, i të gjitha elementëve të kërkuara nga Direktiva nr.2024/1640, datë 31 maj 2024 “Për mekanizmat që duhet të vendosen nga Shtetet Anëtare për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit”, e cila ka ndryshuar Direktivën (BE) 2019/1937, si dhe ka ndryshuar dhe shfuqizuar Direktivën (BE) 2015/849, dhe Rregulloren nr.2024/1624, datë 31 maj 2024 “Për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit” dhe Rregulloren nr.2023/1113, datë 31 maj 2023 “Për informacionin që shoqëron transfertat e fondeve dhe disa aktiveve krypto, si dhe për ndryshimin e Direktivës nr. 2015/849”.

Më tej, duke qënë se Shqipëria është në prag në anëtarësimit në BE (2030), mirëpritet nga të gjitha palët përkatëse dhe të interesuara që Shqipëria të ketë një ligj të ri të vetëm të posaçëm për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit dhe armëve të dëmtimit në masë dhe jo të bëhen ndryshime të tjera në ligjin në fuqi të cilat do të vështirësonin leximin, kuptimin dhe zbatimin dhe ekzekutimin e legjislationit në fjalë, zbatim i cili përfshin shumë aktorë dhe të cilët kanë nevojë për një kuadër të qartë ligjor për ndërhyrje të përbashkëta efektive.

Ky opsion shkon përtej thjesht ndryshimit të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit duke kërkuar rishikimin gjithëpërfshirës të gjithë legjislationit përkatës, përfshirë por pa u kufizuar në, Ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, Ligjin për Bankat,

Ligjin për Lojërat e Fatit, Ligjin për Regjistrin e Pronarëve Përfitues dhe aktet e tjera të lidhura të cilat nuk janë ende të përafuara plotësisht me 3 (tre) aktet e acquis të BE-së të përfshira në këtë Paketë Rregullatore.

Përvoja nga vende të tjera

Për më tepër, duke qenë se Shqipëria është në prag të anëtarësimit në BE (2030), nga të gjitha palët përkatëse dhe të interesuara vlerësohet se Shqipëria duhet të ketë një ligj të vetëm, të ri dhe të posaçëm për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe armëve të dëmtimit në masë, dhe që të mos kryhen ndryshime të mëtejshme në ligjin në fuqi, të cilat do ta ndërlikonin leximin, kuptimin dhe zbatimin e legjislacionit në fjalë, zbatim që përfshin shumë aktorë, të cilët kanë nevojë për një kuadër ligjor të qartë për ndërhyrje të përbashkëta dhe efektive.

Tashmë nuk ekziston një analizë krahasuese gjithëpërfshirëse dhe publike që të tregojë se cili Shtet Anëtar i BE-së është më efektiv ose më i avancuari në zbatimin e të 3 (tre) akteve (Direktiva (BE) 2024/1640, Rregullorja (BE) 2024/1624 dhe Rregullorja (BE) 2023/1113), pasi këto akte janë shumë të reja dhe janë ende në proces zbatimi, ndërsa mbikëqyrja dhe raportimi mbi progresin e Shteteve Anëtare janë ende në zhvillim.

Rregulloret (pjesë e paketës së gjerë AML/CFT) janë drejtpërdrejt të zbatueshme në të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së dhe zëvendësojnë shumë dispozita të ligjeve të mëparshme kombëtare; për rrjedhojë, ato nuk kërkojnë “transpozim” të rreptë kombëtar si një direktivë, por zbatimi praktik pritet të realizohet përmes përgatitjes së autoriteteve kompetente dhe harmonizimit të mbikëqyrjes.

Autoriteti Kundër Pastrimit të Parave (AMLA) një organ i ri i BE-së që ndihmon në koordinimin e mbikëqyrjes dhe zbatimit të rregullave AML filloi veprimtarinë në vitin 2025 dhe përfshin përfaqësues nga shumica e Shteteve Anëtare, duke treguar gatishmërinë dhe angazhimin e tyre relativ në zbatimin e rregullave AML/CFT.

Nuk ka të dhëna të publikuara të qarta që të tregojnë se një shtet është tashmë plotësisht “më i avancuari” në zbatimin e Direktivës dhe Rregulloreve; përkundrazi, procesi lidhet me përgatitjet e autoriteteve kompetente për zbatimin e rregullave të reja brenda afateve të përcaktuara për vitin 2027. Zbatimi është ende në vijim në të gjitha Shtetet Anëtare dhe dallimet në progres do të bëhen më të dukshme vetëm kur të afrohen afatet e transpozimit (deri më 10 korrik 2027). Tashmë nuk ekziston një renditje e publikuar e vendeve sipas nivelit të progresit.

Meqenëse paketa e re e BE-së për AML/CFT është e kohëve të fundit, përvoja e plotë e zbatimit sipas Direktivës (BE) 2024/1640 dhe Rregullores (BE) 2024/1624 është ende duke u zhvilluar në të gjitha shtetet anëtare të BE-së. Megjithatë, përvoja e mëparshme nga zbatimi i direktivave të mëparshme të BE-së për AML dhe reformat e pronësisë përfituese tregojnë mësim të qëndrueshme: reforma ligjore duhet të shoqërohet me mbikëqyrje të fortë, të dhëna të regjistrave me cilësi të lartë, koordinim ndër-agjencor, ndërveprim dixhital, rregulla proporcionale të aksesit dhe udhëzime praktike për subjektet raportuese. Përvoja në vende të tilla si Franca, Gjermania, Holanda, Italia, Estonia, Lituania, Spanja dhe Mbretëria e Bashkuar, tregon se transparenca e pronësisë përfituese dhe efektiviteti i AML varen jo vetëm nga harmonizimi legjislativ, por edhe nga mekanizmat e verifikimit, cilësia e të dhënave, kapaciteti institucional dhe zbatimi i bazuar në rrezik.

Vlen të theksohet neni 78 i Direktivës së 6-të AML, i cili i referohet transpozimit të legjislacionit AML:

“Neni 78 – Transpozimi

- 1. Shtetet Anëtare miratojnë dhe vënë në fuqi ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative të nevojshme për të qenë në përputhje me këtë Direktivë deri më 10 korrik 2027. Ato njoftojnë menjëherë Komisionin për këtë.*

Me përjashtim nga nënparagrafi i parë, Shtetet Anëtare vënë në fuqi ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative të nevojshme për të qenë në përputhje me nenin 74 deri më 10 korrik 2025, me nenet 11, 12, 13 dhe 15 deri më 10 korrik 2026 dhe me nenin 18 deri më 10 korrik 2029. Ato njoftojnë menjëherë Komisionin për këtë.

Kur Shtetet Anëtare miratojnë masat e përmendura në këtë paragraf, ato përmbajnë një referencë ndaj kësaj Direktivë ose shoqërohen me një referencë të tillë me rastin e publikimit të tyre zyrtar. Mënyrat e bërjes së kësaj reference përcaktohen nga Shtetet Anëtare.

2. *Shtetet Anëtare i komunikojnë Komisionit tekstin e masave kryesore të së drejtës kombëtare që ato miratojnë në fushën e mbuluar nga kjo Direktivë.*

Matrica e performancës së opsioneve

Kriteret	Pesha	Opsioni 0	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3
Harmonizimi i legjislacionit shqiptar me acquis të BE-së	4	0(0)	0(0)	3 (12)	4 (16)
Përmbushje e rekomandimeve të FATF-së dhe përputhje e plotë me Legjislacionin e BE.	4	1 (4)	1 (4)	3 (12)	4 (16)
Akresi në informacion dhe dokumentacion dhe bashkëpunimi i AIF dhe institucioneve të inteligjencës financiare me organet vendase dhe të huaja.	4	0 (0)	0 (0)	3 (12)	4 (16)
Rritja e bashkëpunimit me mbikqyrësit financiarë dhe jofinanciarë dhe me subjektet raportuese të ligjit.	4	1 (4)	1 (4)	3 (12)	4 (16)
Kosto-efektivitet	4	0 (0)	0(0)	4(16)	5 (20)
Pikët		8	12	64	84

Në bazë të analizës së matricës së performancës së dy opsioneve të mësipërme rezulton se opsioni 3 (hartimi i një ligji të ri të vetëm të posaçëm) ka më shumë pikë 84, për këtë arsye, opsioni 3 është opsioni i preferuar.

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila strukturë do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*

Struktura përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur do të jetë AIF dhe sistemi i organeve të lidhura të inteligjencës financiare, mbikqyrësit financiarë dhe jofinanciarë të subjekteve raportuese të ligjit, përfshirë por pa u kufizuar në Banka e Shqipërisë, AMF, IKA, Autoriteti i Mbikqyrjes së Lojërave të Fatit, Bordi i Mbikqyrjes Publike (auditorët, kontabilistët e miratuar dhe subjektet e tjera që licencon ky bord), Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Komiteti i Bashkërendimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, Ministria e Drejtësisë (Dhoma Kombëtare e Noterëve, Dhoma Kombëtare e Avokatisë, dhendërmjetësit e pasurive të paluajtshme dhe profesionistët e tjerë, etj.), dhe vetë subjektet raportuese të ligjit, dhe organet ligjzbatuese në rastin e moszbatimit vullnetar

/ të ekzekutimit të detyrueshëm të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit dhe armëve të dëmtimit në masë.

Për zbatimin e këtij Projektligji nuk parashikohet të ketë pengesa të mundshme.

Në lidhje me zbatimin e Projektligjit parashikohen të miratohen aktet nënligjore në zbatim të tij, të miratohet paketa e ligjeve përkatëse, të ndryshohen akte nënligjore nga organet mbikqyrëse financiare dhe jo financiare. Krahas këtyre, do të merren masa për parashikime buxhetore për investime në teknologji informacioni dhe forcim kapacitetesh të punonjësve të autoriteteve përkatëse, si dhe zhvillim të komunikimit dhe bashkëpunimit me autoritetet e huaja dhe ndërkombëtare në funksion të zbatimit të zbatimit efektiv të Projektligjit.

Faza e monitorimit dhe vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e objektivave ose progresin drejt tyre.*

Zbatimi dhe monitorimi i Projektligjit do të organizohen në mënyrë të strukturuar dhe të koordinuar ndërinstitutionale, me qëllim sigurimin e një zbatimi efektiv dhe të unifikuar të dispozitave të tij. AIF dhe organet e lidhura me të kanë të gjitha kompetencat zbatuese dhe mbikqyrëse dhe monitoruese për zbatimin e Projektligjit. AIF dhe organet e lidhura me të kanë të gjitha kompetencat zbatuese dhe mbikqyrëse dhe monitoruese për zbatimin e Projektligjit. AIF do të monitorojë zbatimin e Projektligjit duke pasur të drejtën për të aksesuar çdo dokument dhe çdo të dhënë në çfarëdo forme, duke e marrë atë apo një kopje të tij, duke kërkuar informacion nga çdo organ dhe institucion përkatës që mban informacion dhe dokumente për arritjen e qëllimeve të Projektligjit dhe për të cilat është krijuar AIF, etj. AIF do të realizojë zbatimin e ligjit edhe duke inspektuar dhe duke urdhëruar mbikqyrësit financiarë dhe jofinanciarë dhe subjektet raportuese të ligjit të përmirësojnë cilësinë e zbatimit të Projektligjit dhe të ndërpresin çdo praktikë që është në kundërshtim me dispozitat e Projektligjit. Institucioni kryesor përgjegjës për monitorimin e përputhshmërisë është Agjencia e Inteligjencës Financiare (AIF), ndërsa autoritetet mbikqyrëse sektoriale, përfshirë Bankën e Shqipërisë, Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare, Drejtorinë e Tatimeve, Drejtorinë e Doganave dhe organet e tjera do të jenë përgjegjëse për mbikqyrjen e subjekteve në fushën e tyre të kompetencës.

Mekanizmat kryesorë të zbatimit

- Nxjerrja e akteve nënligjore dhe udhëzimeve për zbatim, për të siguruar interpretim dhe zbatim të qartë nga subjektet raportuese dhe organet mbikqyrëse.
- Hartimi i planeve të trajnimit për subjektet raportuese, autoritetet mbikqyrëse dhe institucionet ligjzbatuese për t'i pajisur me njohuritë e reja procedurale dhe teknike.
- Përditësimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit në AIF, mbikqyrësit sektorialë dhe subjektet raportuese për të lehtësuar raportimin elektronik, shkëmbimin e të dhënave dhe analizën e riskut.
- Rritja e kapaciteteve njerëzore, përfshirë rekrutime ose ri-specializim të stafit për të mbështetur zbatimin praktik të ndryshimeve ligjore.

Mekanizmat kryesorë të monitorimit

- Inspektime dhe kontrole periodike nga Agjencia e Inteligjencës Financiare për të vlerësuar përputhshmërinë e subjekteve me kërkesat e ligjit dhe aktet nënligjore.
- Mbikqyrje e bazuar në risk, e realizuar nga autoritetet sektoriale sipas profileve të riskut të subjekteve dhe veprimtarive ekonomike.
- Raportime të detyrueshme periodike nga subjektet raportuese për transaksionet e dyshimta, veprimtaritë e mbikqyrura dhe masat e marra për menaxhimin e riskut të PP/FT.
- Analizë vjetore e efektivitetit nga AIF, përfshirë matjen e indikatorëve kyç të performancës (KPI) si numri i raportimeve, cilësia e tyre, masat e marra dhe rezultatet në referimet penale.

- Koordinim ndërinstitutional përmes komiteteve dhe forumeve teknike për monitorim të përbashkët të zbatimit dhe adresimin e sfidave.

Përgjegjësitë institucionale

- **Agjencia e Inteligjencës Financiare (AIF):** Monitorim i përgjithshëm, inspektime, analiza të riskut, hartim udhëzimesh, koordinim, raportim vjetor dhe rekomandime për përmirësime.
- **Autoritetet mbikëqyrëse sektoriale:** Mbikëqyrje e subjekteve në përputhje me standardet sektoriale, kryerja e kontrolleve, vendosja e masave administrative dhe raportimi i gjetjeve të AIF.
- **Subjektet raportuese:** Zbatim i detyrimeve ligjore, përditësim i politikave të brendshme, trajnim i stafit, raportim i rastave të dyshimta dhe bashkëpunim me inspektimet e autoriteteve.
- **Institucionet ligjzbatuese:** Trajtimi i referimeve të bëra nga AIF, kryerja e hetimeve dhe koordinimi në rastet e PP/FT.
- **Ministria përgjegjëse:** Ndjekja e progresit të zbatimit dhe rishikimi i kuadrit ligjor, nëse lind nevoja.

Masat kryesore për zbatim efektiv

- Përgatitja dhe publikimi i paketës së akteve nënligjore brenda afateve të përcaktuara.
- Krijimi i një mekanizmi monitorimi të vazhdueshëm të performancës së institucioneve zbatuese.
- Përcaktimi i indikatorëve matës për vlerësimin e efektivitetit.
- Rishikimi periodik i kuadrit rregullator në bazë të rezultateve të monitorimit dhe praktikave ndërkombëtare.

Gjithashtu, për të bërë të mundur zbatimin e tij do të nxirren akte nënligjore, si vendime të Këshillit të Ministrave, etj.

AIF dhe organet e lidhura me të kanë të gjitha kompetencat zbatuese dhe mbikëqyrëse dhe monitoruese për zbatimin e Projektligjit.

AIF do të monitorojë zbatimin e Projektligjit duke pasur të drejtën për të aksesuar çdo dokument dhe çdo të dhënë, në çfarëdo forme, duke e marrë atë apo një kopje të tij, duke kërkuar informacion nga çdo organ dhe institucion përkatës që mban informacion dhe dokumente për arritjen e qëllimeve të ligjit dhe për të cilat është krijuar AIF, etj.

AIF do të realizojë zbatimin e Projektligjit edhe duke inspektuar dhe duke urdhëruar mbikqyrësit financiarë dhe jofinanciarë dhe subjektet raportuese të ligjit të përmirësojnë cilësinë e zbatimit të Projektligjit dhe të ndërpresin çdo praktikë që është në kundërshtim me dispozitat e Projektligjit.

Gjithashtu, për të bërë të mundur zbatimin e Projektligjit do të nxirren një sërë aktesh nënligjore:

- Akt nënligjor për masat kombëtare të ndërmarra ndaj subjekteve ose sektorëve shtesë (Neni 5/2 - Procedura për zgjerimin e fushës së zbatimit)
- Akt nënligjor për publikimin e sektorëve dhe subjekteve ndaj të cilëve zbatohen masat e zgjeruara (Neni 5/9)
- Akt nënligjor për përcaktimin e modaliteteve të regjistrimit minimal, të dhënave që regjistrohen dhe autoritetit përgjegjës (Neni 7/3 – Regjistrimi minimal i subjekteve të detyruara).
 - Akt nënligjor i nxjerrë nga autoritetet mbikëqyrëse për përcaktimin e procedurave dhe kritereve të verifikimit të integritetit dhe përshtatshmërisë të drejtuesve të lartë dhe pronarëve përfitues (Neni 9 - Verifikimi i integritetit dhe përshtatshmërisë të drejtuesve të lartë dhe pronarëve përfitues të kategorive të caktuara të subjekteve të detyruara).
- Akt nënligjor për përcaktimin e formës, periodicitetit, metodologjisë dhe mënyrës së raportimit të të dhënave, si dhe për përcaktimin e autoritetit koordinues (Neni 11/3 – Statistika).
- Akt nënligjor për përcaktimin e mënyrës së sigurimit, administrimit dhe përdorimit të burimeve financiare, njerëzore dhe teknike për ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të AIF.

- Akt nënligjor për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe masave të marra për parandalimin, identifikimin dhe menaxhimin e konflikteve të interesit.
- Akt nënligjor për përcaktimin e rregullave dhe masave përkatëse për sigurinë fizike, teknike, dhe organizative të informacionit, si dhe procedurat për aksesin dhe përdorimin e tij.
- Akt nënligjor për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për krijimin, përdorimin dhe administrimin e kanaleve të komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit midis AIF, autoriteteve kompetente dhe subjekteve të detyruara (Neni 14 – Organizimi dhe funksionimi i Agjencisë së Inteligjencës Financiare).
- Akt nënligjor për mënyrën e caktimit, statusin funksional, kriteret e pavarësisë dhe procedurat e ushtrimit të kompetencave të Oficerit për Mbrojtjen e të Drejtave Themelore (Neni 17 – Oficeri për Garantimin e të Drejtave Themelore).
- Akt nënligjor për përcaktimin e modaliteteve teknike dhe procedurale të dhënies së aksesit në informacion (Neni 18 – Aksesin në informacion).
- Akt nënligjor për përcaktimin e autoriteteve mbikëqyrëse.
- Akte nënligjore të nxjerra nga autoritetet mbikëqyrëse për përcaktimin e procedurave, kriterëve, mënyrës së ushtrimit të mbikëqyrjes dhe masave administrative (Neni 34 – Autoritetet mbikëqyrëse dhe kompetencat e tyre).
- Akte nënligjore të nxjerra nga autoritetet kompetente për përcaktimin e procedurave dhe kriterëve të mbikëqyrjes, si dhe për përcaktimin e kushteve të autorizimit, mënyrës së ushtrimit të mbikëqyrjes dhe bashkëpunimit ndërinstitucional (Neni 35 - Mbikëqyrja e subjekteve të autorizuar që ushtrojnë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë apo në distancë).
- Akt nënligjor për përcaktimin e mënyrës së organizimit dhe funksionimit të autoriteteve mbikëqyrëse, kërkesave për burimet financiare, njerëzore, dhe teknike, kriteret për kualifikimin dhe integritetin e personelit, si dhe procedurat për ushtrimin e kompetencave mbikëqyrëse nga autoritetet mbikëqyrëse (Neni 36 - Garancitë institucionale për ushtrimin e mbikëqyrjes).
- Akt nënligjor për përcaktimin e autoritetit udhëheqës dhe mekanizmave të bashkërendimit (Neni 38 - Bashkërendimi i mbikëqyrjes në rast të shumë autoriteteve mbikëqyrëse).
- Akt nënligjor për përcaktimin e mënyrave të ushtrimit të kompetencave mbikëqyrëse, përfshirë procedurat e inspektimit, verifikimit dhe marrjes së informacionit, si dhe bashkërendimin ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse (Neni 39 - Funksionet e autoriteteve mbikëqyrëse).
- Akt nënligjor për përcaktimin e kriterëve, metodologjisë dhe procedurave të mbikëqyrjes bazuar në klasifikimin e profilit të rrezikut (Neni 42 - Mbikëqyrja e bazuar në rrezik).
- Akt nënligjor për përcaktimin e rasteve kur kërkohet caktimi i një pike qendrore kontakti, si dhe funksionet dhe mënyrat e ushtrimit të veprimtarisë së pikës së kontaktit (Neni 44 - Pika qendrore e kontaktit).
- Akt nënligjor për përcaktimin e modaliteteve dhe procedurave të krijimit, organizimit, funksionimit dhe koordinimit të kolegjeve të mbikëqyrjes (Neni 55 - Rregullimi i mëtejshëm i kolegjeve të mbikëqyrjes).
- Akt nënligjor (udhëzim) për përcaktimin e funksioneve të autoriteteve mbikëqyrëse (Neni 57 - Mbikëqyrja e organeve vetërregulluese).
- Akt nënligjor për përcaktimin e procedurave të konstatimit, të shqyrtimit, të propozimit dhe vendosjes së masave administrative nga autoritetet përgjegjëse (Neni 63 - Gjoha administrative).
- Akt nënligjor për përcaktimin e informacionit konfidencial të shkëmbyer midis autoriteteve (Neni 81 - Bashkëpunimi në lidhje me audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit).
- Akt nënligjor lidhur me masat teknike dhe organizative (Neni 84 - Shkëmbimi i informacionit ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse dhe me autoritete të tjera).
- Akt nënligjor për përcaktimin e mekanizmave të brendshëm të kontrollit dhe mbikëqyrjes për përpunimin e të dhënave (Neni 85 - Përpunimi i disa kategorive të të dhënave personale).
- Subjektet e detyruara miratojnë politika, procedura dhe kontrole të brendshme për të siguruar pajtueshmërinë me këtë ligj dhe aktet nënligjore dhe me çdo akt administrativ të nxjerrë nga mbikëqyrësit, organizimin periodik të programeve të kualifikimit, si dhe përmes miratimit dhe zbatimit të një politike për trajnimin e punonjësve dhe, sipas rastit, agjentëve dhe shpërndarësve, lidhur me masat e ndërmarra për përmbushjen e detyrimeve të Projektligjit, akteve nënligjore dhe akteve administrative të autoriteteve mbikëqyrëse (Neni 8 - Fusha e zbatimit të politikave, procedurave dhe kontroleve të brendshme).
- Aktet nënligjore dhe udhëzimet e autoritetit përgjegjës lidhur me variablat dhe faktorët e rrezikut të përcaktuar (Neni 9 - Vlerësim i rrezikut në shkallë biznesi).

- Subjektet e detyruara caktojnë një person përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe armëve të dëmtimit në masë, i cili është anëtar i organit drejtues në funksionin e tij drejtues, përgjegjës për sigurimin e pajtueshmërisë me këtë ligj, aktet nënligjore në zbatim të tij dhe aktet administrative të autoriteteve mbikëqyrëse në përputhje me Pjesën e Dytë dhe Pjesën e Tretë të Projektligjit (Neni 10 - Funksionet e përputhshmërisë).
- Aktet nënligjore në lidhje me nivelet e sigurisë “thelbësor” ose “i lartë” (Neni 21 - Identifikimi dhe verifikimi i identitetit të klientëve dhe pronarëve përfitues).
- Akt nënligjor për përcaktimin e masave të vigjilencës së duhur, të thjeshtuar (Neni 30).
- Akt nënligjor i autoritetit kompetent mbi pranimin e pagesa të kryera me karta anonime të parapaguara të lëshuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë mbi bazën e një vlerësimi të provuar të riskut të ulët, (Neni 58 - Llogaritë anonime dhe aksionet e prurësit dhe garancitë e aksioneve të prurësit).
- Akte nënligjore ose udhëzime për përcaktimin e kërkesave minimale për politikën, procedurat dhe kontrollat e brendshme (Neni 23 - Politikën, procedurat dhe kontrollat e brendshme për të garantuar zbatimin e masave kufizuese).

Pjesa e Tretë

- Aktet nënligjore të nevojshme për zbatimin e Pjesës të Tretë të Projektligjit të miratuara nga autoritetet mbikëqyrëse kompetente brenda fushës së përgjegjësisë të tyre (Neni 34 - Procedura e Komitetit).
- Akte nënligjore dhe udhëzime për zbatimin e Pjesës së Tretë të Projektligjit të miratuara nga autoritetet mbikëqyrëse kompetente, brenda fushës së përgjegjësisë të tyre, lidhur me:
 - a) masat që duhet të merren nga ofruesit e shërbimeve të pagesave.
 - b) masat që duhet të merren nga ofruesit e shërbimeve të kryptoaseteve.
 - c) aspektet teknike që lidhen me debitimet direkte dhe me veprimtarinë e ofruesve të shërbimeve të inicimit të pagesave, duke marrë në konsideratë rolin e tyre specifik në transaksionet e pagesave.
 - d) karakteristikat e një qasjeje të bazuar në rrezik për mbikëqyrjen e ofruesve të shërbimeve të kryptoaseteve, si dhe procedurat e mbikëqyrjes (Neni 36 - Udhëzimet dhe aktet zbatuese).

Pjesa e Katërt

- Aktet nënligjore të miratuara nga Ministri i Financave për masat e mëposhtme për të siguruar zbatimin uniform të kontroleve nga organet kompetente:
 - a) modelet e formularit të deklaratës, dhe formularit informues.
 - b) kriteret për kornizën e përbashkët të menaxhimit të riskut dhe, më konkretisht, kriteret e riskut, standardet dhe zonat prioritare të kontrollit, bazuar në informacionin e shkëmbyer, dhe politikave të Republikës së Shqipërisë dhe ato ndërkombëtare dhe praktikën më të mira;
 - c) formatin për formularin e dërgimit të informacionit
 - ç) rregullat dhe formatin për informacionin statistikor të anonimizuar (Neni 16 - Aktet nënligjore)

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuara në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës	1.00	0.97	0.93	0.90	0.87	0.84	0.81	0.79	0.76	0.73
Kosto për buxhetin – një herë	17.1	6.7								
Kosto për buxhetin – në vazhdim			0.7	0.7	0.7	0.7	0.7	0.7	0.7	0.7
Kosto për biznesin – një herë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – një herë	1.8									
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim	1,816.4	1,816.4	1,816.4	1,816.4	1,816.4	1,816.4	1,816.4	1,816.4	1,816.4	1,816.4
Kosto në total	1,835.3	1,823.0	1,817.1	1,817.1	1,817.1	1,817.1	1,817.1	1,817.1	1,817.1	1,817.1

Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës	1,835.3	1,761.4	1,696.3	1,638.9	1,583.5	1,530.0	1,478.2	1,428.2	1,379.9	1,333.3
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – një herë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim	2,198.9	2,198.9	2,198.9	2,198.9	2,198.9	2,198.9	2,198.9	2,198.9	2,198.9	2,198.9
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim		0.7	0.7	0.7	0.7	0.7	0.7	0.7	0.7	0.7
Përfitimi në total	2,198.9	2,198.9	2,198.2	2,198.2	2,198.2	2,198.2	2,198.2	2,198.2	2,198.2	2,198.2
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës	2,198.9	2,124.6	2,052.1	1,982.7	1,915.6	1,850.8	1,788.3	1,727.8	1,669.4	1,612.9
Vlera aktuale e koston në total	18,923.0									
Vlera aktuale e përfitimit në total	15,665.0									
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e koston në total	3,258.0									

Analiza e kosto & përfitimeve përfshin koston e buxhetit të shtetit dhe koston e përfitimet e biznesit-subjekteve raportuese.

A. Kostoja e buxhetit të shtetit

Në këtë kosto përfshihet **kostoja e vlerësuar për zhvillimin e moduleve të reja të sistemit të IT-së së AIF-s**. Bazuar në studimin e bëshmërisë (feasibility study) kostoja e zhvillimit të moduleve të reja është përllogaritur të shkojë në masën 250,000 EUR ose 23.8 mln lekë. Kësaj kostoje i shtohet edhe **kostoja** mesatare vjetore e shtuar e **mirëmbajtjes së sistemit të IT-së** e llogaritur në masën **0.7 mln në vit**.

Grupet e biznesit që kanë përgjegjësi për raportimin e transaksioneve, të cilëve hyrja në fuqi e ligjit do t'ju sjellë disa kosto shtesë administrative janë: (i) 11 banka (me një total prej 418 degësh bankare); (ii) 405 zyra noteriale; (iii) 621 zyra të këmbimit valutor dhe (iv) 39 institucione jo-financiare.

Kostot kryesore për biznesin përfshijnë **kostot për familjarizimin fillestar** me ndryshimet që do pësoje ligji dhe **kostot në vazhdim (detyrimi administrativ)**. Të dy këto kategori kostosh bazohen në përllogaritjen e koston së burimeve njerëzore (oret e punës) të strukturave të përfshira në shqyrtimin e ndryshimeve ligjore si dhe përbushjen e detyrimit administrativ që lidhet me ndryshimet e procedurave të brendshme të bizneseve për ti përshtatur ndryshimeve ligjore si dhe procesit të raportimit.

a). **Kostot e familjarizimit** lidhen me familjarizimin fillimisht me ndryshimet që sjell ligji i ri. Kostot e familjarizimit vlerësohen në **masën e 1,572,291 lekë** dhe është një kosto që ndodh vetëm vitin e parë pas hyrjes në fuqi të ligjit.

b) **Kostot e detyrimit administrativ** përfshijnë kosotot e (i) rishikimit dhe adoptimit të procedurave të brendshme të subjekteve; (ii) verifikimit të dokumentacionit për transaksionin e dyshuar; (iii) raportimit pranë AIF; (iv) paraqitja e dokumentacionit të kerkuar dhe dërgimi i informacionit pranë AIF. Në këto kategori kostosh përfshihet kostoja e burimeve njerëzore dhe logjistika (riprodhimi i dokumentacionit të rasteve që raportohen). Kostot totale administrative vlerësohen në **masën prej 1,936 mln lekë** në total ndërsa detyrimi administrativ shkon në nivelin **1,816 mln lekë**. Duke qenë se raportimi i transaksioneve nuk futet në “*core bussines*” të këtyre strukturave, kostoja në biznesin e tyre kryesor nuk vlerësohet e konsiderueshme dhe përllogaritet në nivelin më pak së 1% të operacioneve të tyre kryesore të biznesit.

Niveli i koston zbritëse është mbajtur në nivelin 3.5% të përcaktuar në manualin e RIA-s. Kostoja totale e zbritur për periudhën 10 vjecare vlerësohet të jetë në masën **15,636 mln lekë**.

Në **përfitimet ekonomike** përfshihen: (i) përfitimet që do të vijnë nga shtimi i moduleve në sistemin e IT i cili do të ndikojë në një **ulje të kostove të stafit të strukturave raportuese**. Automatizimi i procesit të raportimit pas futjes së sistemit IT, dhe kryerjen e operacioneve të shkëmbimit të informacionit, shqyrtimit e raportimit do të zvogëlojë kohën e punës së stafeve në këto struktura, duke përbërë një kursim administrativ të kostove të burimeve njerëzore. Gjithashtu (ii) parashikohet **kursimi nga zvoglimi i kostove për të riprodhuar dokumentacionin mbështës** në momentin e raportimit pasi keto procese më pas gjithashtu do të kryhen on-line (*paper-less*), dhe janë kursime administrative që lidhen me aspektin ambjental të eliminimit të përdorimit të dokumentave në formë fizike. Në total vlerësimi i përfitimit ekonomik të biznesëve vlerësohet në masën **2,198.9 mln lekë në vit**, ndërsa në total **për dhjetë vitet e para në masën 18,927.7 mln lekë**.

Në total **Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e koston në total nga futja në fuqi e ligjit përlllogaritet në masën 3,258 mln leke**.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1	18,923.0	15,665	3,258.0
Opsioni 2	18,923.0	15,665	3,258.0

Nuk ka ndryshime ndërmjet kostove dhe përfitimeve midis dy opsioneve pasi që të dy opsionet përfshijnë kosto dhe përfitime të njëjta sic u paraqitën në Shtojcën 2/a.

MINISTRI

PETRIT MALAJ